

PËRMBAJTJA

2	Paraqitje e Raportit Publik 2020 nga Drejtori i SHISH-it
5	COVID-19 dhe ndikimi mbi sigurinë
6	Shfrytëzimi i situatës së shkaktuar nga COVID-19 nga shtete/ shërbime të inteligjencës kundërshtarë
7	Dezinformimi, keqinformimi dhe aktivitetet influencuese
9	Kërcënimet kibernetike në situatën e krijuar nga COVID-19
11	Ndikimi i COVID-19 në aktivitetin e organizatave terroriste dhe ekstremiste
11	Roli i teorive konspirative në tablonë e ekstremizmit të dhunshëm
12	Kërcënimi terrorist në rajon dhe vendin tonë
13	Impakti në emigracionin e jashtëligjshëm
14	Impakti në aktivitetin e krimit të organizuar
15	Impakti mbi korrupsionin
16	Produkti informativ
18	Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve teknike për t'u përballur me kërcënimet aktuale dhe perspektive
19	Strategjia e SHISH-it
21	Strategjia e burimeve njerëzore 2020-2023
23	Procesi i kontrollit dhe verifikimit të figurës
24	Ndryshimi i statusit të punonjësit të SHISH-it
25	Ligji i statusit të punonjësit të SHISH-it
27	Rekrutimet 2020
29	Trajnimet - Qendra e Trajnimit
30	Struktura e re e SHISH-it
31	Gratë në komunitetin e inteligjencës
32	Aktiviteti financiar i SHISH-it
33	Fjalori terminologjik i sigurisë dhe inteligjencës
36	Lista e shkurtesave

Paraqitje e Raportit Publik 2020

Të nderuar lexues,

Kam nderin t'ju paraqes, në faqet e këtij Raporti të tretë Publik, veprimtarinë njëvjeçare të Shërbimit Informativ të Shtetit, duke u ndalur te disa nga arritjet, sfidat, problematikat, prioritetet dhe objektivat tona.

Gjatë vitit 2020, Shërbimi Informativ i Shtetit është mbështetur dhe vlerësuar nga vendimmarrësit politikë. Si rezultat i kësaj mbështetjeje, u miratuan ndryshimet në Ligjin "Për statusin e punonjësit të SHISH-it", si dhe disa vendime të qeverisë, që sjellin në nivel më të lartë punën, performancën dhe trajtimin financiar të punonjësve tanë. Qëllimi i ndryshimit të ligjit ishte përmirësimi i statusit të punonjësit të SHISH-it, duke promovuar cilësinë dhe efektivitetin në kryerjen e detyrës, nëpërmjet vlerësimit të aftësive profesionale dhe etike. Këto përmirësime ligjore garantojnë, ndër të tjera, status e mbrojtje të veçantë për kolegët tanë që përballen me krimin e organizuar e korrupsionin, terrorin dhe fenomene të tjera të rrezikshme që cenojnë sigurinë kombëtare.

Gjatë 2020-ës, duke u mbështetur te prioritetet e veprimtarisë vjetore nga Kryeministri, SHISH-i është angazhuar në përmbushjen e detyrave e misionit të tij, duke u përqendruar në drejtime të tilla si: kërcënimet që vijnë nga tensione të ndryshme gjeopolitike e veprimtari jo-miqësore informative, parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar në përgjithësi dhe narkotrafikut në veçanti, krimeve në ekonomi, korrupsionit e kërcënimeve kibernetike.

SHISH-i është kundërpërgjigjur duke shtuar fokusin e punës, kapacitetet operative dhe informative, me plane konkrete për t'i parandaluar dhe goditur këto dukuri, në bashkëpunim me agjencitë ligjzbatuese dhe shërbimet e agjencitë informative partnere. SHISH-i ka thelluar më tej bashkëpunimin në nivel qendror e vendor me Prokurorinë e Përgjithshme, SPAK-un, Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtorinë e Policisë së Shtetit,

SHÇBA-në, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Drejtoritë e Policisë në qarqe dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore. Kemi forcuar dhe shtuar kapacitetet njerëzore dhe teknologjike në kundërvënien ndaj kërcënimeve kibernetike të cilat duhet theksuar se, që prej fillimit të pandemisë globale të COVID-19, janë rritur ndjeshëm. Puna e shtuar online e institucioneve shtetërore dhe private, për shkak të situatës së COVID-19, ka krijuar hapësira për shtim të sulmeve të kësaj natyre, si për krimin kibernetik, ashtu edhe për spiunazhin kibernetik. Sulmet nga aktorë kibernetikë të vendeve jo-miqësore kanë pasur si objektiva institucionet qeveritare shqiptare dhe biznesin privat. Ndërsa aktorë shtetërorë e jo-shtetërorë kanë vijuar aktivitetin dezinformues e influencues online, propagandën ekstremiste, me impakt të opinionit publik. SHISH-i ka përmirësuar punën e strukturave përkatëse e ka krijuar struktura të reja për aplikimin e protokolleve të sigurisë dhe kundërvënien efektive ndaj këtyre veprimtarive.

Pandemia e COVID-19 ka sjellë ndryshim të mjedisit të sigurisë, mënyrës së të punuarit të aktorëve në fushën e sigurisë kombëtare, të aktiviteteve të inteligjencës dhe objektivave të kësaj pune. Trysnia mbi ekonominë, sistemin shëndetësor dhe veprimtarinë e përditshme, bëri që SHISH-i të përballej me dukuri të reja dhe të përshtaste metodat e punës me situatën e krijuar. Janë vënë re përpjekje për uljen e perceptimit publik mbi efikasitetin e institucioneve shtetërore për të përballuar gjendjen, valë keqinformimi, teori konspirative e përhapje lajmesh të rreme nga aktorë globalë jo-perëndimorë, që synojnë rritjen e influencës dhe pengimin e integriteteve euro-atlantike në rajon. Shtetet dhe shërbimet inteligjente jomike kanë përdorur forma klasike dhe hibride për mbledhje informacioni dhe shpërndarje të retorikës, influencim të opinionit publik me synime politike dhe ekonomike, si dhe janë angazhuar në operacione të fshehta informative në funksion të synimeve të tyre gjeostrat-

tegjike. Në këtë kuadër, SHISH-i shtoi bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse si AKSHI dhe institucionet e tjera objekt sulmesh, ka ofruar ekspertizën e strukturave të dedikuara për këtë kërcënim. SHISH-i njëherësh ka marrë masa për të rritur sigurinë e brendshme të shërbimit dhe të personelit, duke zbatuar protokollet e miratuara nga autoritetet, shtuar kapacitetet teknologjike për rritjen e sigurisë kibernetike dhe përshtatur veprimtarinë informative-operative me kushtet e reja.

SHISH-i ka ndjekur në dinamikë zhvillimet në Rajon. Situata në Ballkanin Perëndimor, pavarësisht zhvillimeve pozitive si anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO, është e cënueshme nga një sërë faktorësh, ku veçohen mosmarrëveshjet ndërshtetërore e ndëretnike; problematikat politike të brendshme; veprimtaria e vendeve të treta; prania e LHT-ve në zonat e konfliktit, si dhe ndjekësve të tyre; prania dhe aktiviteti i grupeve të krimit të organizuar me lidhje rajonale e ndërkombëtare. Megjithatë, këto problematika ndërshtetërore nuk kanë cenuar drejtpërdrejt sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë. Sfida më e rëndësishme në rajon mbetet normalizimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe njohja reciproke e dy shteteve.

Edhe gjatë vitit 2020, iu dha rëndësi e veçantë procesit të verifikimit dhe kontrollit të figurës, një proces ky i fokusuar në cilësinë, objektivitetin dhe paanshmërinë e kontributit të SHISH-it në këtë proces.

Nga ana strukturore, SHISH-i ka vënë në zbatim me sukses strukturën e re të miratuar nga Kryeministri, me objektiv ndërtimin e kapaciteteve për t'u bërë një Shërbim më dinamik dhe bashkëkohor.

Poashtu, pavarësisht kushteve të pandemisë, SHISH-i ka realizuar me sukses konkursin e rekrutimit të kandidatëve për punonjës të SHISH-it. SHISH-i vijon të ketë në vëmendje aspektin gjinor të përfaqësimit të punonjësve, duke rritur numrin e punonjësve femra në pozicione drejtuese.

SHISH-i ka vijuar kontributin me produkt informativ analitik, dinamik, objektiv e të dobishëm për vendimmarrësit politikë, institucionet e larta shtetërore, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe SHIVH. SHISH-i ka rritur e konsoliduar rolin informativ dhe bashkëpunimin




me institucionet e tjera kontribuuese në Sigurinë Kombëtare, si Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mbrojtjes dhe AISM, Prokuroritë, Policinë, DPPPP, etj.

Gjatë 2020-ës, SHISH-i ka konsoliduar e rritur më tej bashkëpunimin me partnerët, në veçanti me ata strategjikë e rajonalë, me struktura të NATO-s dhe BE-së, në përballimin e sfidave të përbashkëta ndaj rreziqeve të spiunazhit, krimit të organizuar ndërkombëtar dhe të terrorizmit. Shërbimet partnere kanë shprehur disa herë vlerësime pozitive për ekspertizën e SHISH-it në çështjet e Ballkanit Perëndimor dhe kanë thelluar më tej bashkëpunimin dhe shkëmbimin informativ në drejtim të aktivitetit të aktorëve të jashtëm jo-miqësorë në rajon dhe kërcënimeve nga terrorizmi.

Së fundi, do të dëshiroja t'ju bëja me dije se, Raporti Publik 2020 është vijim i përpjekjeve konkrete në kuadër të ambicies për përmirësimin e imazhit dhe hapjes me publikun. Në emrin tim dhe të kolegëve, përfitoj nga rasti t'ju përcjell angazhimin maksimal të Shërbimit Informativ të Shtetit, në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore në funksion të sigurisë kombëtare.

HELIDON BENDO
Drejtori i SHISH-it



COVID-19 DHE NDIKIMI MBI SIGURINË



Viti 2020 u shenjua nga pandemia e shkaktuar nga COVID-19 me impakt edhe në çështjet e sigurisë. Kriza e shkaktuar nga COVID-19 sfidoi infrastrukturën shëndetësore ekzistuese mjekësore, përkeqësoi ekonominë globale me ndikim edhe në procesin e globalizimit dhe integritet politik, stabilitetin politik, duke sjellë fragmentarizim të mëtejshëm dhe dobësim të perceptimit publik mbi efektshmërinë e institucioneve ndërkombëtare, përgjigjen kolektive, besueshmërinë në informacionin shkencor dhe aftësitë e qeverive për të përballuar me efikasitet situatën.

Situata u karakterizua me lulëzim të agjendave populiste e nacionaliste, u shoqërua me një valë propagande dhe dezinformacioni, u shndërrua në një terren të favorshëm për aktorë globalë jo-perëndimorë për të shënjestruar sistemet demokratike dhe ndikuar perceptimin publik mbi to. Situata e pandemisë, me gjasë do të ketë ndikim të fortë dhe të qëndrueshëm në dinamikat gjeopolitike, ekonomike dhe të sigurisë.

Ekonomitë e vendeve të rajonit dhe të vendit tonë u ndikuan nga situata e shkaktuar nga COVID-19. Qeveritë rishikuan buxhetet vjetore dhe morën masa stimuluese për të

penguar ngadalësimin e ekonomisë. Një zgjatje në kohë e pandemisë dhe një recesion më i thellë në vendet e Bashkimit Evropian do të mund ta vështirësonin përballimin e krizës ekonomike në zhvillim. Në rajon, pavarësisht prirjeve për investime nga vende jo-perëndimore, BE vijon të jetë kontribuuesi më i madh. Çdo boshllëk në investimet e huaja direkte do të synohet nga aktorë ekonomikë të këtyre vendeve për të zgjeruar influencën. Dhënia e mbështetjes financiare për sektorin privat do vijojë të jetë sfidë dhe mund të shfrytëzohet për investime apo kreditime nga aktorët jo-perëndimorë për synimet e tyre gjeostrategjike.

Kriza e shkaktuar nga COVID-19 dhe problematikat ekonomike, si në shkallë globale dhe në nivel rajonal, ndikuan në rritjen e paqëndrueshmërisë social-politike. Vendet me procese zgjedhore të përcaktuara më parë, u përballen me shtyrje të këtyre proceseve apo me pasiguri e mungesë besimi publik në vendet që realizuan të tilla. Megjithatë, proceset zgjedhore në vendet e rajonit (RMV, Serbi, Mal i Zi) u zhvilluan dhe nuk pati problematika sigurie për funksionimin normal të sistemit politik.

U shtuan akuzat ndaj qeverive dhe elitave

politike për masa jo të përshtatshme dhe keqmenaxhim të situatës, duke i konsideruar ato si shkaktoare të panikut ekonomik, kurse kufizimet e masat shtrënguese u perceptuan si kufizime të lirive themelore të njeriut, karakterizuar edhe nga demonstrime të dhunshme, por pa ndikim, në situatën e sigurisë. Në vendet e rajonit, pati prirje të reflektimit të modeleve të demonstrimeve të dhunshme në shumë vende evropiane dhe më gjerë, por jo në të njëjtat përmasa me to. Në shumë raste,

në rrjetet sociale dhe mediat online janë bërë thirrje nga individë apo grupe të caktuara për të nxitur e frymëzuar pakënaqësi dhe reagim popullor kundër masave shtrënguese të marra nga qeveritë gjatë situatës së shkaktuar nga pandemia. Pasiguria dhe teoritë konspirative që karakterizuan rrjetet sociale dhe mediat online ndikuan në dobësim të perceptimit publik për një përgjigje kolektive ndërkombëtare e kombëtare të efektshme lidhur me menaxhimin e pandemisë.

SHFRYTËZIMI I SITUATËS SË SHKAKTUAR NGA COVID-19 NGA SHTETE/SHËRBIME TË INTELIGJENCËS KUNDËRSHTARE

Aktorët globalë jo-perëndimorë shfrytëzuan situatën e shkaktuar nga COVID-19 për synimet e tyre gjeostrategjike, forcimin e pozitës së tyre si aktorë ndërkombëtarë, përçarjen e kohezionit në BE/NATO dhe ndërkombëtar, si dhe kanë mbështetur narrativat e njëri-tjetrit në mjedisin informativ sipas synimeve të tyre.

Gjithashtu, përdorën një spektër të gjerë të mjeteve hibride për të ndërmarrë operacione informative përgjatë pandemisë COVID-19, si: ndërmarrja e fushatave mediatike, qarkullimi i lajmeve të rreme, nxitja e shpërndarja e teorive konspirative nëpërmjet medias e rrjeteve sociale, angazhimi i shërbimeve të inteligjencës dhe aktorëve kibernetikë shtetërorë dhe jo-shtetërorë.

Kriza shëndetësore globale u shfrytëzua për të promovuar agjenda përçarëse për t'u faktorizuar në arenën ndërkombëtare dhe

për të rritur impaktin e aktiviteteve të tyre influencuese. Aktorët shtetërorë kundërshtarë shfrytëzuan interesin global të medias sociale rreth COVID-19 për të përhapur narrativat përkatëse, propaganduar superioritetin e tyre, në raport me shtetet demokratike, për të

shënjestruar sistemet demokratike e për të sjellë argumente të reja që mbështesin pikëpamjet e tyre sipas synimeve përkatëse.

Kjo propagandë përfshiu edhe çdo informacion të gjeneruar nga mediat perëndimore që theksojnë euro-skepticizmin në rritje, si dhe promovuan çdo lajm mbi modelet qeverisëse të tyre si superiore ndaj atyre perëndimore.

Vendet e rajonit u pasqyruan si të dobëta dhe paafta për e menaxhuar situatën, me theks lënien e tyre pa mbështetje nga vendet perëndimore edhe organizmat ndërkombëtare, si NATO-ja dhe BE-ja.



DEZINFORMIMI, KEQINFORMIMI DHE AKTIVITETET INFLUENCUESE

Situata e shkaktuar nga COVID-19 u shoqërua me fushata agresive dezinformimi dhe keqinformimi, të cilat ndikuan negativisht në përgjigjen reaguese dhe perceptimin e publikut mbi rrezikshmërinë reale të pandemisë.

Aktorë shtetërorë jo-perëndimorë dhe ata jo-shtetërorë që veprojnë për llogari të tyre, u angazhuan në fushata dezinformacioni dhe në lidhje me COVID-19, duke rënduar krizën dhe minuar përpjekjet për tejkalimin e saj, përfshi supozime se Perëndimi e ka krijuar virusin, se virusi është një armë biologjike, se BE-ja po dështon në menaxhimin e pandemisë, institucionet euro-atlantike nuk kanë kapacitete reaguese kolektive, se do të shpërbëhen nën këtë presion, etj.

Mediat online dhe rrjetet sociale u bënë përcjellëse të publiku i teorive konspirative dhe raportimeve false. Përveç përdorimit të aseteve të tyre mediatike, apo mediave të financuara e orientuara prej tyre për të drejtuar fushata të shënjestruara dezinformacioni, edhe shpërndarja jo e qëllimshme e informacionit fals dhe teorive konspirative në hapësirën online, ndenja e pasigurisë të publikut dhe nevojës për përgjigje lidhur me COVID-19, i favorizoi për të përhapur narrativat e tyre, propaganduar superioritetin dhe shënjestruar sistemet demokratike si të dështuara.


Në rajon dhe vendin tonë, propaganda dhe dezinformimi përbëjnë një ndër elementët e fushatës hibride që përdorin aktorët jo-perëndimorë në përballjen e tyre gjeopolitike me Perëndimin për arritjen e objektivave

strategjike për t'iu kundërvënë dhe penguar proceset integruese euro-atlantike në rajon. Fokusi propagandues në hapësirën online u vu në problematikat historike: keqtrajtimi i supozuar i vendeve të rajonit nga faktori perëndimor, duke pretenduar përdorimin e standardeve të dyfishta kur bëhet fjalë për zgjidhjen e çështjeve specifike në vendet e Ballkanit

Perëndimor; hezitimi i supozuar i Perëndimit për të shpejtuar pranimin në BE të vendeve të BP; dobësitë e brendshme, veçanërisht në vendet pro-perëndimore (si p.sh. nacionalizmi, minoritetet etnike dhe institucionet e dobëta shtetërore); përshkrimi i faktorit shqiptar në rajon si kërcënim për rajonin dhe rolin e shqiptarëve si nxitës të politikave nacionaliste për të ashtuquajturën “Shqipëria e Madhe”. Paralelisht me objektivin për të penguar integrimin euro-atlantik, kjo propagandë synoi të promovonte imazhin dhe interesat e tyre, të

inkurajonte ndjenjat kundër NATO-s dhe të nxiste tensione ndëretnike me qëllim dobësimin e kohezionit në rajon.

Në morinë e teorive konspirative që karakterizuan situatën në shkallë globale, edhe në vendet e rajonit dhe Shqipëri, pati qarkullim të tyre në rrjetet sociale dhe mediat online, të cilat i përcollën në gjuhët vendase. Një numër teorish konspirative janë shpërndarë nga platforma propaganduese, sociale e mediatike, që reflektojnë edhe publikimet në kanalet mediatike shtetërore dhe jo-shtetërore të vendeve jo-perëndimore, të regjistruara në këto vende por edhe jashtë tyre, pa lidhje të qarta



shtetërore. Shpërndarja e qëllimtë, por edhe për motive klikimi, nga llogari rrjetesh sociale, patën ndikim në perceptimin e publikut, me impakt në ulje të besueshmërisë për masat kundër COVID-19 dhe rrezikshmërinë reale të pandemisë. Hapësira online e vendeve të rajonit, por edhe vendit tonë, u bë shpërndarëse e këtyre narrativave.


Aktivitetet influencuese dhe të inteligjencës të aktorëve jo-perëndimorë u shtuan gjatë fushatave zgjedhore, ngjarjeve të rëndësishme dhe proceseve vendimmarrëse me rëndësi strategjike për integrimin euro-atlantik, me synimin e bllokimit apo vonimit të këtyre proceseve, amplifikimin e problematikave ekzistuese, paraqitjen e rajonit si një rajon jotërheqës për Perëndimin, por edhe shënjestrimin e politikave të vendeve perëndimore ndaj vendeve të rajonit si me dy standarde dhe të paafta për t'u dhënë zgjidhje problematikave të tij.

Këta aktorë, gjithashtu janë të interesuar të zgjerojnë influencën ekonomike në rajon nëpërmjet investimeve dhe projekteve strategjike dhe për ta përdorur atë si trampolinë për influencë politike në të ardhmen, sipas synimeve të tyre gjeostrategjike. Nevojat e vendeve të rajonit për të mbushur boshllëqet financiare, i bëjnë këto investime atraktive në rajon. Situata e dobët ekonomike në vendet e BP dhe problemet ekonomike në disa prej vendeve të BE-së, kanë çuar në avancimin e këtyre investimeve në këto vende.

Pandemia e shpejtoi përdorimin e diplomacisë agresive për të promovuar superioritetin e sistemeve politike autoritare. Propaganda që shoqëroi dërgesat dhe asistencën prej tyre në muajt e parë të pandemisë u shoqërua me rritje të propagandës dhe si instrument për të dëshmuar superioritet dhe rivalitet me Perëndimin. Narrativat e tyre shpesh konvergjuan dhe mbështetën reciprocisht njëra-tjetrën në synimet e tyre gjeostrategjike. Mediat online dhe rrjetet sociale përcollën në gjuhët e rajonit këto narrativa, propagandën për “menaxhimin efikas të pandemisë”, qasjen e tyre humanitare ndaj vendeve të

rajonit, me kujdesje të pasqyrimin të tyre si ndihma humanitare ndaj popujve të rajonit, etj. Platformat online kanë luajtur rolin e shumëfishuesve të propagandës e dezinformacionit, duke bërë të mundur ndërlihdjen e audiencës shqipfolëse me operacionet informative.

Objektivat kryesore të operacioneve informative të këtyre aktorëve janë nxitja dhe amplifikimi i ndasive politike, sociale, etnike, fetare; minimi gradual i besimit në proceset, në sistemin demokratik, institucionet kombëtare e ndërkombëtare; përçarja e kohezionit kombëtar dhe midis vendeve anëtare të NATO-s dhe BE-së; manipulimi i perceptimit publik mbi to dhe paraqitja e modeleve të tyre qeverisëse si të suksesshme në menaxhimin e situatës në raport me shtetet perëndimore dhe organizmat ndërkombëtare.



KËRCËNIMET KIBERNETIKE NË SITUATËN E KRIJUAR NGA COVID-19


Pandemia COVID-19 dëshmoi se si një situatë me vëmendje kaq të madhe publike e ndërkombëtare mund të përdoret nga aktorët kibernetikë shtetërorë dhe jo-shtetërorë për spiunazh kibernetik, aktivitete influencuese dhe krim kibernetik.

Aktivitetet online, shtetërore dhe jo-shtetërore, u përdoren edhe nga aktorët shtetërorë dhe krimi kibernetik si vektorë të rinj sulmi, për të arritur synimet e tyre. Risku i sulmeve kibernetike ndaj institucioneve në sektorët shëndetësorë, bankarë, të telekomunikimit dhe entiteteve

politike vendimmarrëse, u rrit ndjeshëm. Aktorët kibernetikë shtetërorë e jo-shtetërorë që veprojnë për llogari të tyre, kanë shfrytëzuar pandeminë e COVID-19 edhe për të grumbulluar inteligjencë, me synim influencimin e opinionit publik sipas interesave të tyre. Shërbimet e inteligjencës së këtyre vendeve u angazhuan në operacione informative, grumbullim informacioni për synime konkurruese gjeostrategjike.

Kriminelët kibernetikë dhe shtete ose aktorë kibernetikë të mbështetur nga shtete, përdorën krizën, duke shfrytëzuar frikën e popullatës dhe nevojën për informacion, për të arritur qëllimet e tyre, duke përdorur fushata që lidhen me COVID-19. Puna e shtuar online e institucioneve shtetërore por edhe private, për shkak të situatës, dhe niveli i sigurisë që shpesh është më i ulët për shkak edhe të kohës së vogël në dispozicion për të përforcuar masat mbrojtëse, mundësuan vektorë shtesë sulmesh. Aktorët jo-shtetërorë dhe hakera kriminale e shfrytëzuan situatën për aktivitete përfitimi.

SHISH-i bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse për kërcënimet kibernetike dhe sugjeron, sipas specifikave të evidentuara, marrjen e masave përforcuese të sigurisë për mbrojtjen e rrjeteve elektronike nga sulme të mundshme kibernetike, qoftë për motive spiunazhi kibernetik, por edhe motive krimi kibernetik. Kalimi në shërbimet online në shumë sektorë bankarë e ekonomikë, do të rritë edhe kërcënimet kibernetike ndaj tyre. Çdo projekt digjitalizimi duhet shoqëruar me masat e duhura mbrojtëse.





- Në muajin maj 2020, është identifikuar një sulm kibernetik në drejtim të rrjetit informatik të një dikasteri ekonomik shtetëror.
- Në fund të muajit shtator 2020, u identifikuan kërcënime për sulme kibernetike ndaj infrastrukturës së një operatori ekonomik (OE), që shkaktoi ndërprerjen e shërbimit për rreth 4 orë. Sulmi ishte i fokusuar në bllokimin e shërbimeve të ofruara nga ky operator ekonomik.
- Sulme kibernetike, qoftë edhe përpjekje testuese, janë evidentuar edhe ndaj vetë rrjeteve elektronike të paklasifikuara të Shërbimit por, për shkak të masave strikte të sigurisë, nuk kanë mundur thyerjen e tyre apo marrjen e informacionit sensitiv e të klasifikuar.
- Agjencitë ligjzbatuese shqiptare kanë arrestuar një ish-anëtar të organizatës MEK më datë 8 tetor 2020, të cilit i janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale pajisje elektronike. Ky individ u arrestua i dyshuar për veprat penale: “Përgjim i paligjshëm i të dhënave kompjuterike”; “Ndërhyrje në sistemet kompjuterike”; “Ndërhyrje në të dhënat kompjuterike”, “Keqpërdorimi i pajisjeve”. Dyshohet se ky shtetas, nëpërmjet veprimeve të ndryshme, kryente komunikime nëpërmjet një aplikacioni mesazhimi në rrjet, të cilin e përdorte duke e lidhur me numrat e telefonave celularë të shtetasve të tjerë. Pas këtij veprimi, ky shtetas siguronte kodin e verifikimit të aplikacionit në formë të ndryshme nga këta shtetas, duke vënë në funksionim aplikacionin në aparatet e tij kompjuterike.

NDIKIMI I COVID-19 NË AKTIVITETIN E ORGANIZATAVE TERRORISTE DHE EKSTREMISTE

Që me deklarimin e pandemisë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, organizatat e dhunshme ekstremiste kanë parë mundësitë për të përfituar nga kriza, për qëllime propagande e indoktrinimi. Të dyja organizatat terroriste, ISIL/DAESH dhe Al-Qaeda, kanë pretenduar se virusi është “*ndëshkimi i Zotit ndaj Perëndimit*” dhe sëmundja “*ushtar i Allahut*”. Mesazhet e shpërndara nga media zyrtare e organizatave terroriste rreth COVID-19, që nxisin urrejtje dhe bëjnë thirrje për sulme, u shtuan. Propaganda ishte në një linjë me retorika të mëparshme nga këto grupime, që shpjegojnë fatkeqësitë natyrore në “*vendet armike*” si “*vullnetin e Zotit*”.

ISIL/DAESH vazhdoi të nxitë ndjekësit e tij të kryejnë sulme të vetmuara në Perëndim gjatë pandemisë, por mundësitë konkrete operacionale për të drejtuar aktivitetet terroriste jashtë rajonit të konfliktit kanë pasur kufizime të ndjeshme. Për shkak të masave kufizuese ndërkombëtare, u bë më e vështirë lëvizja e operativëve terroristë dhe materialeve logjistike për aktivitete terroriste nëpër kufij. Ndërkohë, ka vazhduar aktivitetin

terrorist në rajonin e konfliktit në Siri, në Irak, Afganistan përmes degëve të saj, duke shfrytëzuar zonat me vakum sigurie.

Propaganda përmes internetit mbetet nga elementët më të përdorur nga organizatat terroriste me synim përhapjen e ideologjisë radikale, shtimin e radhëve të mbështetësve, rekrutimin e luftëtarëve të rinj, si dhe nxitjen e frymëzimin e individëve për planifikimin dhe kryerjen e akteve të terrorit. Kalifati virtual i pretenduar i organizatës vijon të mbetet ende aktiv, me përmbajtje të re propagandistike, por edhe me riciklim të materialeve të vjetra, me diskutime e debate në internet mbi çështje që shqetësojnë rrjetet mbështetëse radikale, e të tjera, që kanë si qëllim indoktrinimin dhe shtimin e radhëve të ndjekësve.

Pasojat e krizës së COVID-19 në terma afatmesëm dhe afatgjatë, mund të krijojnë vakume sigurie, të cilat mund të shfrytëzohen nga organizatat terroriste. Në vende konflikti dhe me histori konfliktesh, ato do të tentojnë të ofrohen si alternativa për publikun.

ROLI I TEORIVE KONSPIRATIVE NË TABLONË E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Situata e shkaktuar nga COVID-19 dhe teoritë konspirative që e shoqëruan atë, luajtën rol edhe në tablonë ekstremiste të dhunshme, të motivuar ideologjikisht, në lulëzim të agjendave populiste e amplifikim të ekstremizmave të tjerë si nacionalist, racor dhe gjinor, të nxitur e mbështetur nga grupime të caktuara, të cilat rritën propagandën për përdorimin e dhunës si mjet për të nxitur ndryshimin që duan të shohin në shoqëri. Propaganda ekstremiste ka ndikuar shpesh në akte dhune ndaj forcave policore, kampeve të refugjatëve, akuza kundër politikave ndaj refugjatëve dhe emigrantëve si shkatërruese të homogjenitetit etnik.

Teoritë e konspiracionit përdoren për këtë synim, edhe për shkak se “janë tërheqëse” për

ndjekësit në rrjetet sociale, duke ndikuar në uljen apo dobësimin e perceptimit publik në sistemet demokratike. Lëvizjet populiste, por edhe ato civile anti-vaksinë, mund të përdorin situatën për të zgjeruar mbështetësit e tyre dhe për t’u faktorizuar më pas në shoqëri dhe skenën politike, duke çuar përpara agjendat e tyre.

Në vendet perëndimore, situata e COVID-19 u shoqërua me demonstrime të dhunshme ndaj autoriteteve policore e institucioneve shtetërore. Edhe në vendet e rajonit pati thirrje nga elementë e grupime të veçanta për të reflektuar demonstrimet e vendeve evropiane. Nuk përjashtohet manipulimi i mundshëm i tyre nga aktorë jo-perëndimorë për të shkaktuar destabilitet, fenomen i evidentuar në SHBA dhe vendet evropiane.

KËRCËNIMI TERRORIST NË RAJON DHE VENDIN TONË

Kërcënimi terrorist në Ballkanin Perëndimor (BP) dhe vendin tonë, gjatë vitit 2020, ka variuar nga i ulët në të mesëm, varësisht nga situata specifike kërcënuese. Në vend dhe rajon, nuk ka pasur akte terroriste, kurse synimet apo planet e mundshme për të ndërmarrë të tilla janë neutralizuar në faza të hershme nga autoritetet e sigurisë. Sulmet nga aktorët e vetmuar dhe grupe të vogla pa koordinim direkt me organizata terroriste mbeten potencialisht të mundshme.

Gjatë kësaj periudhe, nuk janë evidentuar raste të operativëve terroristë, që të kenë përdorur rrugën e emigracionit të jashtëligjshëm për të hyrë në rajon dhe vendin tonë, ndërkohë që rruga ballkanike vijon të mbetet një linjë e rëndësishme për emigracionin ilegal që shkon drejt Evropës. Nuk është i përjashtuar shfrytëzimi i kësaj rruge nga elementë apo operativë për synime e akte terroriste apo përdorim të vendit dhe rajonit me synim kalimin në vendet e BE-së për aktivitete terroriste.

Situata e familjarëve të luftëtarëve të huaj terroristë nga rajoni dhe vendi ynë në kampet kurde paraqitet e përkeqësuar. Organizata terroriste i braktisi banorët e të ashtuquajturit *Shteti Islamik* pa të ardhurat bazë për jetesë. Ndërkohë, tani që organizata ka nevojë për kapacitete njerëzore, u bën thirrje grupeve ekstremiste dhe operativëve lokalë të angazhohen në sulme për lirimin të tyre. Organizata synon të përdorë këtë potencial njerëzor për të fuqizuar grupimet terroriste me burime njerëzore. Kampet janë shndërruar në terren të përshtatshëm për aktivitete radikalizuese. Situata e vështirë humanitare në kampet e refugjatëve dhe të paraburgimit lehtëson radikalizimin e fëmijëve dhe familjarëve.

Riatdhesimi i kësaj kategorie përbën një risk më të ulët krahasuar me qëndrimin në rajonin e konfliktit nën ndikim të elementëve radikalë dhe operativëve të organizatave dhe grupeve terroriste, duke mundësuar ndjekjen sipas legjislacionit por edhe mundësimin e

programeve të deradikalizimit dhe ri-integrimit të kategorive të veçanta.

Risku i shfrytëzimit të hapësirave virtuale në rrjetet sociale nga grupe dhe individë me profil radikal e terrorist për të përhapur ideologjitë ekstremiste, si dhe për të rekrutuar persona të tjerë për grupet terroriste, mbetet i lartë për rajonin përgjithësisht, dhe për trojet shqipfolëse në veçanti. Gjuha shqipe zë një vend të konsiderueshëm në hapësirën online për sa u përket materialeve propagandistike. Propaganda në gjuhën shqipe, pavarësisht se ku dhe nga kush prodhohet, është një trafik me audiencë publikun shqipfolës në tërësi.

Individë e grupe të caktuara vijojnë ndjekjen e ligjëratave me përmbajtje ekstremiste e shpërndarje literature në grupe të vogla e kryesisht mes lidhjeve të tyre, si brenda vendit edhe me të tilla në rajon. Shtetasit e dënuar për



terrorizëm dhe mbështetës të tyre në sistemin e burgjeve kanë vijuar të mbajnë profil radikal dhe me tendenca radikalizimi të tjerëve. Futja e tyre nën regjimin “41 bis” ka si qëllim kryesor ndalimin e aktiviteteve radikalizuese, ndërprerjen e vijimit të aktivitetit të krimit të organizuar me orientime e koordinime nga të dënuar nga drejtësia për aktivitete kriminale të rënda jashtë sistemit penitenciar. Edhe pse vendosja nën këtë regjim e kësaj kategorie ka krijuar revolta e reagime në këtë sistem, vlerësohet i rëndësishëm aplikimi i këtij regjimi për kategoritë e përzgjedhura.

Rrjetet sociale po përdoren edhe për propagandë dhe nxitje të përçarjes fetare, mes linjave të ndryshme brenda një besimi fetar. Ndërkohë, një seri sektesh e misionesh, me aktivitete në rajon dhe vendin tonë, që u referohen interpretimeve të ndryshme të pjesëve nga librat e shenjtë të fesë së krishterë, propagandojnë e shpërndajnë literaturë në kuadër të proselitizmit dhe indoktrinimit, mosnjohje të shtetit demokratik dhe aplikim strikt të praktikave satanike, që, në disa raste, kanë sjellë cenim të jetës me impakt publik për rolin dhe misionin e tyre.



IMPAKTI NË EMIGRACIONIN E JASHTËLIGJSHËM

Në kushtet e mbylljes së kufijve për shkak të COVID-19, trendi i hyrjeve të jashtëligjshme u reduktua. Gjithashtu, rrjetet kryesore të mundësuesve/lehtësuesve të trafikut kryesisht e reduktuan aktivitetin e tyre. U vërejt prani e shtuar e klandestinëve në zonat urbane. Masat e vendosura nga shtetet e prekura nga pandemia për distancimin social, si dhe mbyllja e disa mjediseve të përdorura si pika takimi për emigrantët ose midis emigrantëve dhe lehtësuesve, sollën që pjesa më e madhe e ndërveprimit të kryhej online.

Aktiviteti i lehtësuesve dhe emigrantëve në rrjetet sociale u rrit, si për promovimin e “ofertës dhe kërkesës” dhe për marrjen e informacionit rreth pandemisë, se deri në çfarë grade u prekën shtetet e destinacionit apo tranzitit dhe mbi masat e ndërmarra nga autoritetet. Me lehtësimin e masave, prej fundit të muajit maj e vijim, numri i emigrantëve të ndaluar në territorin shqiptar, pësoi rritje.

Rrjetet kriminale, të cilët vlerësohen me lidhje brenda dhe jashtë vendit, vijojnë të shfrytëzojnë këtë kategori për kalime të jashtëligjshme përkundrejt përfitimeve financiare. Një pjesë e mirë orientohen nga këto rrjete nga jashtë vendit, nga origjina, në vendet tranzit deri në destinacion. Shtetas shqiptarë e të huaj, me ose pa bashkëpunim mes tyre, kanë favorizuar emigracionin e paligjshëm nëpërmjet prodhimit dhe shpërndarjes edhe të dokumenteve false.

Sipastëdhënave të Ministrisë së Brendshme, gjatë 2020-ës, një numër total prej 17,500 emigrantësh të paligjshëm kanë hyrë në Shqipëri. Numri më i vogël korrespondon me masat shtrënguese për shkak të pandemisë, më pas trendi fillon të rritet, me lehtësimin e masave shtrënguese. Ka dy qendra të dedikuara për emigrantët në vendin tonë, njëra e hapur dhe tjetra e mbyllur. Qendra e mbyllur përdoret për të mbajtur emigrantët me sfond të dyshimtë, me qëllim që të vijohet më

tej me intervista dhe verifikime nga agjencitë e zbatimit të ligjit në bashkëpunim me Shërbimin. Numri i emigrantëve që kërkojnë azil është i ulët,

kryesisht deklarojnë se nuk duan të qëndrojnë në vendin tonë, por e përdorin atë si rrugë tranzit drejt vendeve të BE-së.

IMPAKTI NË AKTIVITETIN E KRIMIT TË ORGANIZUAR

Në kushtet e pandemisë COVID-19, grupet e përfshira në krimin e organizuar në përgjithësi dhe të narkotrafikut në veçanti, ndryshuan mënyrat e veprimit në raport me masat kufizuese, për të pasur akses te financimet e aktivitetit kriminal, drogat apo ngarkesat me lëndë narkotike.

Lidhur me kultivimin e bimëve narkotike, vërehet se raporti kërkesë-ofertë që ka ndikur në rritjen e çmimit dhe se kërkesat e grupeve kriminale, të rajonit e me gjerë, për kanabis sativa të kultivuar në Shqipëri, vijuan të nxisin dhe favorizojnë përfshirjen e individëve e grupeve kriminale shqiptare në këtë aktivitet, si brenda dhe jashtë vendit.

Nga sasitë e trafikuar të lëndës narkotike kanabis sativa, përkundrejt kultivimeve, kuptohet se ka ende në gjendje kanabis sativa të prodhimit të viteve të mëparshme, të fshehur në ambientet private të personave që posedojnë lëndë narkotike.

U evidentuan interesime dhe përpjekje të grupeve kriminale e individëve të përfshirë në këtë aktivitet antiligjor për përfshirje në kultivim të kanabis sativa. Për shkak të rritjes së masave anti kanabis në Shqipëri, vërehet prirja e kultivimit nga grupe e anëtarë të grupeve kriminale jashtë vendit në ambiente të mbyllura, ndërsa brenda vendit kultivimi u krye në zona të largëta, parcela të vogla dhe/ose ambiente të mbyllura, të përshtatura për këtë aktivitet, por edhe zhvendosje e këtij aktiviteti në vendet e rajonit.

Grupet kriminale të përfshira në trafikun e drogave të forta jashtë vendit kanë vijuar aktivitetin duke ndryshuar metodat e veprimit varësisht situatës së kufizimeve, kanë shumëfishuar tipin e përfshirjes në kriminalitet, duke vazhduar përdorimin e sistemeve financiare për të fshehur financat e paligjshme dhe pastrimin e këtyre përfitimeve. Për shkak

të mbylljes së kufijve ajrorë e tokësorë, anëtarët e grupeve kriminale tentuan rrugë të reja për të sjellë në Shqipëri të ardhurat e produktit kriminal.

Organizimi i atentateve apo akteve të dhunshme me pasoja për jetën, si brenda ashtu dhe jashtë vendit, vijnë të kenë si shkak kryesor pazaret e prishura për shkak të aferave të drogës, gjobëvënieve dhe/apo hakmarrje e hasmëri të vjetra. Kjo nxiti grupet kriminale apo individët të jenë vazhdimisht të përfshirë në konflikte dhe eliminime fizike ndërmjet tyre. Kryerja e atentateve është zhvendosur në zona ku objektivi i tyre nuk ka aktivitet kriminal, kjo duke bashkëpunuar edhe me grupe të treta kriminale, të cilat nuk janë pjesë e konfliktit, por angazhohen në dhënien e informacionit të nevojshëm për organizimin e atentatit. Vrasësit me pagesë, të cilët përgjithësisht janë persona që nuk kanë lidhje apo konflikte me viktimat, përdoren shpesh për arsye të mosdekonspirimit, të njohjes në zonën e veprimit dhe kryerjes së atentatit.

Në kuadër të Operacionit “Forca e Ligjit” evidentohet e njëjta formë ligjore e regjistrimit të pasurive të luajtshme e të paluajtshme dhe aktivitetëve ekonomike, kryesisht në emër të familjarëve apo të tretëve, lidhje të afërta bashkëpunuese familjare dhe shoqërore. Përtej formave klasike tashmë të konkretizuara mbi përdorimin e parave të gjeneruara nga veprimtaria e kundërligjshme, evidentohet se subjektet lëndorë të AN janë më të kujdesshëm në realizimin e fazës së integritetit të vlerave monetare në fusha të ndryshme të ekonomisë.

Vijuan përpjekjet e subjekteve lëndorë për tjetërsimin “de jure” të titujve të pronësisë, të lidhjeve familjare apo lidhje të tyre shoqërore; nëpërmjet aktit të dhurimit; në disa “duar” nëpërmjet aktit të shitblerjes për t’u larguar nga origjinuesi; të bashkëshortët, duke zgjidhur më parë lidhjen

martesore; me qëllim për të “shpëtuar” atë çfarë kanë “ndërtuar” me paratë e gjeneruara nga veprimtaria e kundërligjshme, duke synuar kamuflimin mbi qasjen e tyre para enteve publike

e zyrtare, në funksion të mosgjurmueshmërisë, sekuestrimit e konfiskimit. Në të njëjtën mënyrë, është vepruar edhe me ndryshimet në aktivitetet ekonomike në zotërim të tyre.

IMPAKTI MBI KORRUPSIONIN

Edhe gjatë kësaj periudhe, korrupsioni ka vijuar në sistemin e drejtësisë, por edhe në disa sektorë të administratës shtetërore, ku konstatohet se palët ndërveprojnë të nxitura nga interesi i përfitimit të përbashkët.

Dhënia e mitës apo ryshfeti ka për qëllim ushtrimin e ndikimit të paligjshëm në marrjen e një shërbimi publik nga personat e interesuar, ndërsa marrja e mitës në shumicën e rasteve është e lidhur ngushtë me zyrtarët publikë (ofruesit e shërbimeve publike), të cilët përfshihen në kundërligjshmëri kundrejt shpërdorimit të detyrës.

Në sistemin e drejtësisë, punonjës të veçantë (prokurori/gjykata), janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, të shfaqur në forma si: ushtrim i ndikimit të paligjshëm dhe ndërveprimi korruptiv, me qëllim lehtësimin e pozitës së të pandehurit, nëpërmjet ndryshimit të masës së sigurisë nga arrest me burg në arrest shtëpie ose duke aplikuar dhënien e dënimit alternativ.

Elementë të veçantë të këtij sistemi, të cilët janë në proces verifikimi të pastërtisë së figurës në kuadër të procesit të Vettingut, po e shfrytëzojnë këtë periudhë në funksion të përfitimit personal, duke shpërdoruar detyrën kundrejt ndërveprimi korruptiv, nëpërmjet dhënies së vendimeve gjyqësore në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore në fuqi.

Në administratë, punonjës të veçantë përfshihen në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tenderim publik, ushtrim i ndikimit të paligjshëm, në sistemin tatimor, pushtetin vendor, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës kundrejt ndërveprimi korruptiv.

Pastrimi i produktit të veprës penale, kontrabanda e mallrave të akcizës, evazioni fiskal dhe cenimi i sigurisë ushqimore, evidentohen si format më të përhapura të krimeve në ekonomi.

SHISH-i ndërvepron me agjencitë ligjzbatuese në funksion të bashkëpunimit ndërinstucional, si pjesë e Komitetit Kombëtar të Koordinimit për Parandalimin dhe Luftën Kundër Krimit të Organizuar, lidhur me zbatimin e Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, si dhe në funksion të dhënies së mbështetjes informative për Operacionin Forca e Ligjit (OFL).



PRODUKTI INFORMATIV

Në përgatitjen e produktit informativ, krahas parametrave të lidhura me cilësinë dhe objektivitetin, SHISH-i i ka kushtuar vëmendje informacionit dinamik dhe në kohë, si dhe dobisë së tij për politikëbërësit, vendimmarrësit e nivelit strategjik dhe për institucionet e tjera shtetërore të sigurisë.



SHISH-i ka vazhduar të informojë autoritetet kryesore, si Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ministri të tjera.

Bashkëpunimi dhe shkëmbimet e informacioneve me shërbimet e huaja partnere, në nivel strategjik apo operacional, mbi kërcënimet e përbashkëta është rritur dhe thelluar. Bashkëpunimi me institucionet e zbatimit të ligjit, si Policia e Shtetit, Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion (SPAK), DPPPP, etj., është shtuar.

Produkti informativ i destinuar për autoritetet e larta shtetërore ka qenë me vlera informuese dhe njohëse mbi situata të caktuara dhe kërcënimet ndaj

sigurisë kombëtare, formave dhe prirjeve të tyre, ose ka paraqitur probleme specifike, i shoqëruar me parashikime dhe rekomandime. Ndërkaq, produkti për agjencitë ligjzbatuese ka qenë konkret, aktual dhe i dobishëm në evidentimin e veprimtarive të paligjshme.


Në terma statistikore, SHISH-i ka prodhuar gjatë 2020-ës një total prej 4989 informacionesh për klientët brenda dhe jashtë vendit, shoqëruar me një rritje cilësore të këtij produkti final. Krahasuar me 2019-ën, ka pasur 595 produkte më tepër, ose 13% më shumë.



Shpërndarja e produktit informativ
 ■ brenda vendit ■ jashtë vendit

Informacioni për klientët brenda vendit është rritur, sidomos në nivel qendror, duke sjellë baraspeshë në përqindje (50% me 50%) me produktin informativ për SHIVH, përkatësisht 2482 informacione për klientët brenda vendit dhe 2507 informacione për SHIVH.


Për klientët brenda vendit, produkti informativ i SHISH-it ka shërbyer për informimin e institucioneve të larta të shtetit, konkretisht Presidentin e Republikës me 349 informacione,




Produkti informativ për institucionet e larta shtetërore

Kryeministrin e Shqipërisë me 435 informacione, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme me 230 informacione, Ministrinë e Brendshme me 144 informacione, Ministrinë e Drejtësisë me 21 informacione, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me 15 informacione, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me 15 informacione, Ministrinë e Mbrojtjes me 10 informacione dhe 27 informacione për ministritë e tjera sipas specifikës.

SHISH-i ka vijuar bashkëpunimin me institucionet në fushën e hetimit dhe zbatimit të ligjit, konkretisht me Prokurorinë, sidomos SPAK-un, Policinë e Shtetit, veçanërisht në kuadër të OFL, me DPPPP dhe me institucione të tjera. SHISH-i ka ofruar për DPPSH 860 informacione, Prokurorinë 174 informacione, DPPPP 987 informacione, DPV 752 informacione, si dhe për disa institucione të tjera.



Produkti informativ për agjencitë ligjzbatuese



NGRITJA DHE PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE TEKNIKE PËR T'U PËRBALLUR ME KËRCËNIMET AKTUALE DHE PERSPEKTIVE

Evoluimi i mëtejshëm i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe telekomunikimit (IT&T) gjatë këtij viti, ka sjellë nevojën për qasjen dhe shfrytëzimin gjithmonë e më të madh të mundësive dhe teknikave të ofruara. Për të qenë në hap me këto zhvillime, SHISH-i ka vijuar zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve IT&T qoftë në pikëpamjen infrastrukturore, të burimeve njerëzore ashtu edhe në aspektin procedural e normativ.

Gjatë vitit 2020, SHISH-i ka vijuar digjitalizimin e proceseve të punës duke sjellë në këtë mënyrë lehtësira për punonjësit dhe duke rritur ndjeshëm shpejtësinë e ndërveprimit midis hallkave të ndryshme të cilat janë pjesë e proceseve. Digjitalizimi në përgjithësi është një proces i gjatë dhe i vështirë për t'u aplikuar, qoftë në aspektin teknik ashtu edhe në atë normativ.

Përparimi i ndjeshëm i arritur gjatë vitit 2020 në këtë drejtim, na detyron dhe motivon që të vijojmë më tej dhe me hapa të shpejtë e të sigurt me këtë proces të rëndësishëm të shekullit në të cilin jetojmë.

Gjatë vitit 2020, SHISH-i ka vijuar me përmirësimin e infrastrukturës IT&T, duke mbajtur hapin e zhvillimeve bashkëkohore të infrastrukturave IT&T dhe duke ruajtur një balancë të arsyeshme ndërmjet aplikimit të zhvillimeve të reja dhe praktikave më të mira në këtë fushë, duke i dhënë një rëndësi të veçantë aspekteve të sigurisë

kibernetike, si pasojë e evoluimit dhe përdorimit gjithnjë e më të madh të hapësirës kibernetike e një game të gjerë kërcënimesh nga ky drejtim.

Në këtë aspekt, gjatë vitit 2020, SHISH-i ka aplikuar metoda dhe teknologji të reja në mbrojtjen e perimetrave dhe parandalimin e çdo situatë katastrofike nga sulmet kibernetike, referuar edhe kërcënimeve të shfaqura rishtazi edhe si pasojë e situatës pandemike.

Gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin 2019, është hasur një aktivitet i shtuar keqdashës dhe kërcënues drejtuar infrastrukturës publike të SHISH-it.

Me qëllim evidentimin e kërcënimeve dhe korrelimin e aktorëve dhe faktorëve keqdashës/kërcënues, SHISH-i ka zhvilluar me tej kapacitetet në pikëpamjen e analizimit dhe inteligjencës së kërcënimeve kibernetike, duke aplikuar sisteme dhe platforma me burim të hapur të modifikuara përshtatshmërisht, apo COTS (Commercial off-the-shelf).

Zhvillimet in-house, përdorimi/modifikimi i softuerëve me burim të hapur dhe COTS, si dhe aplikimi rigoroz i politikave dhe procedurave të sigurisë në lidhje me infrastrukturën IT&T kanë qenë në fokus gjatë vitit 2020.

Ekipi IT&T në SHISH vijon vetëzhvillimin profesional, në mënyrë që të jetë i përditësuar dhe të mbajë ritmin e risive teknologjike dhe aplikimit të tyre në mënyrë të arsyeshme.

STRATEGJIA E SHISH-IT

Hartimi i Strategjisë së SHISH-it 2020-2023 përbën një akt të rëndësishëm institucional, në kuadër të përpjekjeve të institucionit për të shfrytëzuar maksimalisht të gjithë kapacitetet në funksion të përmbushjes së misionit. Ndryshimet e vazhdueshme në mjedisin e sigurisë, të cilat ndikojnë në kohë prioritarizimin e sfidave, me të cilat përballet institucioni ynë, kërkojnë gjithashtu një qasje tjetër ndaj tyre. SHISH-i synon në mënyrë të vazhdueshme të jetë fleksibël dhe i adaptueshëm në gjetjen e formave dhe metodologjive të punës, që i sigurojnë avantazhe në aktivitetet dhe veprimtaritë e tij.

Kjo strategji përfshin të gjitha aspektet e veprimtarisë së institucionit dhe mundëson vlerësime e planifikime të kapaciteteve për realizimin e misionit dhe objektivave të përcaktuara në dokumentet përkatëse si ai i Sigurisë Kombëtare, strategjitë e lidhura ngushtë me objektin e punës së SHISH-it dhe Prioritetet Vjetore të Kryeministrit. Ai ofron qasjen e një

“biznes-plani”, që në themel për funksionimin me sukses të tij ka planifikimin me efikasitet edhe të kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore, të cilat është e nevojshme t’i zhvillojmë në frymën e perspektivës.

Në përmbushje të misionit - sigurimi në kohë i informacionit objektiv, cilësor dhe të dobishëm për autoritetet e larta shtetërore vendimmarrëse, për

rreziqe dhe kërcënime nga jashtë dhe brenda vendit, të drejtuara ndaj interesave dhe sigurisë kombëtare të vendit, të NATO-s dhe vendeve aleate - SHISH-i duhet të udhëhiqet nga vizioni - një shërbim inteligjent bashkëkohor, i adaptueshëm me mjedisin e sigurisë dhe me ndikim në forcimin e sigurisë kombëtare dhe kontribut në sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare.

Dy shtyllat kryesore në Strategjinë e SHISH-it prezantohen në përgjegjësitë për përmbushjen e misionit dhe instrumentet e politikave të forcimit të kapaciteteve organizative dhe funksionale të institucionit, të cilat përshkruajnë dhe përcaktojnë angazhimet

Qasja mban parasysh shtatë pjesë përbërëse:

1. Misioni, Vizioni dhe Vlerat;
2. Mjedi i sigurisë, që përshkruan një vlerësim në tërësi të mjedisit të sigurisë, duke konsideruar zhvillimet dhe ndryshimet në mjedisin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
3. Situata e SHISH-it, që përshkruan organizimin dhe funksionimin aktual të institucionit;
4. Përgjegjësitë në përmbushje të misionit, ku përshkruhen prioritetet e misionit dhe pritshmëritë në përmbushjen dhe realizimin e tyre;
5. Instrumentet dhe politikat e forcimit të kapaciteteve organizative dhe funksionale të institucionit, të cilat përshkruajnë dhe përcaktojnë përgjegjësitë konkrete për realizimin e përgjegjësiave në përmbushjen e misionit;
6. Menaxhimi i riskut, ku përshkruhet metodologjia dhe mënyra sesi përcaktohen dhe menaxhohen faktorët e riskut nga institucioni ynë në realizimin e misionit;
7. Zbatimi i strategjisë, që siguron një udhëzues të përgjithshëm organizativ, me qëllim për t’iu përgjigjur më mirë nevojave të kësaj strategjie.

në objektiva konkrete dhe specifike në përmbushje të misionit.

Mbështetur në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, strategjitë e tjera kombëtare dhe ndër-institucionale, angazhimet ndërkombëtare të vendit, përgjegjësitë në përmbushje të misionit përcaktojnë nevojën për sigurimin e informacionit në kohë dhe objektiv, në përputhje me nevojat e vendimmarrjes politike dhe kontributit për institucionet ligjzbatuese, për sigurinë kombëtare, si dhe angazhimeve tona në kontributin për sigurinë ndërkombëtare.

Përgjegjësitë në përmbushje të misionit janë trajtuar në rrafsh horizontal, pa marrë përsipër prioritarizimin/klasifikimin e tyre, duke marrë në konsideratë procesin e prioritarizimit të tyre vjetor nga kryeministri dhe dinamikës në ndryshim të mjedisit të sigurisë.

Në përgjegjësitë në përmbushje të misionit të institucionit tonë janë përcaktuar:

- kundërvënia ndaj aktiviteteve të inteligjencës kundërshtarë;
- kundërvënia ndaj ekstremizmit dhe terrorizmit;
- kundërvënia ndaj krimit të organizuar;
- kundërvënia ndaj krimit ekonomik dhe korrupsionit;
- kundërvënia ndaj proliferimit/Armëve të Dëmtimit në Masë (ADM-ve);
- kundërvënia ndaj kërcënimeve mjedisore;
- kundërvënia ndaj kërcënimeve të shëndetit publik;
- kundërvënia ndaj kërcënimeve kibernetike;
- kundërvënia ndaj kërcënimeve hibride;
- kundërvënia ndaj veprimtarive nga jashtë, që cenojnë sigurinë dhe interesat kombëtare

Instrumentet dhe politikat e forcimit të kapaciteteve organizative dhe funksionale të institucionit, përcaktuar si mekanizma efektivë dhe orientues në realizimin e përgjegjësiave në përmbushje të misionit, janë formuluar në plan strategjik dhe operacional, duke përfshirë të gjithë infrastrukturën dhe kapacitetet e burimeve njerëzore, me qëllim për të maksimalizuar shfrytëzimin me racionalitet dhe brenda planifikimeve buxhetore për periudhën afatmesme 2020-2023. Si instrumente dhe politika të forcimit të kapaciteteve organizative dhe funksionale

të institucionit janë përcaktuar:

- sigurimi i kontributit informativ, objektiv, cilësor dhe të dobishëm;
- rritja e kontributit në sigurinë kolektive;
- konsolidimi dhe zgjerimi i infrastrukturës operacionale;
- përmirësimi dhe zgjerimi i kapaciteteve analitike;
- thellimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit në kuadër të partneriteteve;
- menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
- zhvillimi i kapaciteteve IT&T;
- zhvillimi i kapaciteteve mbrojtëse dhe analitike ndaj kërcënimeve kibernetike;
- politikëbërja në hartimin e legjislacionit;
- forcimi i qasjes me publikun.

Në procesin e implementimit të kësaj strategjie janë të angazhuara të gjitha njësitë, përfshi ato teknike-administrative, të cilat brenda kompetencave dhe autoritetit të tyre, kanë përgjegjësitë përkatëse në përmbushjen e misionit dhe të objektivave në lidhje me instrumentet dhe politikat e forcimit të kapaciteteve organizative dhe funksionale të institucionit. Të gjitha strukturat, sipas linjave të tyre, është e nevojshme të bashkëpunojnë dhe koordinojnë që, në mënyrë të integruar, të zhvillojnë qasjen ndaj qëllimit dhe synimit të përbashkët, për të krijuar sistemin më të mirë organizativ dhe funksional për arritjen me sukses të objektivave.

Instrumentet dhe politikat e forcimit të kapaciteteve organizative dhe funksionale të institucionit janë tërësisht në funksion të përmbushjes dhe realizimit të përgjegjësiave të misionit, dhe si tregues të matshëm në zbatimin e kësaj strategjie, janë zbërthyer në objektiva specifike dhe aktivitete që institucioni duhet të ndërmarrë në kuadër të një Plani Veprimi. Ky Plan Veprimi është dokumenti shtojcë që shoqëron strategjinë, i cili është përlllogaritur të jetë brenda Kërkesave Buxhetore Afatmesme të SHISH-it, duke synuar jo vetëm maksimalizimin e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore, por edhe ato financiare. Kostot financiare janë në përputhje me tavanet e miratuara në Ligjin 58/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” dhe kërkesat buxhetore të SHISH-it sipas dokumentit përfundimtar të PBA-së 2021-2023.



STRATEGJIA E BURIMEVE NJERËZORE 2020-2023

Po aq i rëndësishëm është edhe Strategjia e Burimeve Njerëzore 2020-2023 ku, për herë të parë, SHISH-i ka formuluar perspektivën e politikave të tij në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, si një nga elementët thelbësorë në arritjen e suksesit. Mbështetur në “Strategjinë e SHISH-it 2020-2023”, në politikat mbi menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, qasja e re ndaj burimeve njerëzore ka qëllim jetësimin e këtyre politikave, përmes përcaktimit të objektivave strategjike dhe specifike. Një nga synimet kryesore, përcaktuar në këtë strategji është rekrutimi dhe zhvillimi i një stafi me kapacitet dhe ekspertizë të ndryshme, duke promovuar diversitetin, aftësitë profesionale, teknike, kulturore dhe punën në ekip, në përmbushjen e misionit.

Struktura e burimeve njerëzore është faktor i rëndësishëm i vendimmarrjes së institucionit dhe organizëm thelbësor në përcaktimin dhe aplikimin e proceseve menaxhuese dhe zhvilluese, për të garantuar efektivitetin e objektivave të institucionit. Vlerësimi i kapitalit njerëzor, si aspekt jetësor dhe thelbësor për performancën e institucionit, është në qasje me transformimin e vazhdueshëm konceptual dhe funksional të strukturave që merren me menaxhimin e tyre.

Kjo strategji do të kontribuojë në zhvillimin e një kulture të nxitjes së performancës së lartë të punonjësve, duke siguruar që institucioni të ketë punonjës me aftësi dhe specifika profesionale të duhura. Ajo do të inkurajojë një qasje profesionale dhe etike në menaxhimin e burimeve njerëzore, në të gjithë ciklin e jetës së tyre, si pjesë e SHISH-it.

Ndryshimet e vazhdueshme demografike, të cilat kërkojnë përmirësimin e metodologjive në tërheqjen, përzgjedhjen, rekrutimin dhe punësimin e punonjësve, sipas nevojave të punës; përmirësimi i sistemit të menaxhimit të punonjësve të rinj, duke krijuar qasje pozitive të tyre në mjedisin e ri të punës, kulturën specifike të mjedisit në të cilin operon SHISH-i; përmirësimi i sistemit të menaxhimit të performancës; krijimi i një sistemi planifikimi dhe zhvillimi të integruar, të qartë dhe organizuar, të nevojave për rritjen dhe aftësimin profesional; hartimi i politikave mbi diversitetin e stafit dhe përfaqësimin e balancuar të raporteve gjinore në komunitetin e inteligjencës; krijimi dhe zhvillimi i kulturës së lidershit; etj., janë disa nga sfidat, mbi të cilat në këtë strategji janë përcaktuar dhe formuluar objektivat strategjike dhe specifike.

Menaxhimi efektiv i ciklit të jetës së punonjësve në SHISH përmes përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve specifike si të rekrutimit, punësimit,

zhvillimit, ecurisë në karrierë, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e çdo punonjësi, dhe rrjedhimisht atë të institucionit, është në themel të politikave për menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

Sfidë dhe objektiv për të ardhmen është krijimi i një sistemi të integruar të menaxhimit me qasje të drejtpërdrejtë dhe unifikuar në kulturën dhe objektivat strategjike të institucionit. Zbatimi i politikave të institucionit është i lidhur ngushtë me objektivat sektoriale (në nivele njësishe) për menaxhimin, zhvillimin dhe motivimin e burimeve njerëzore, përmes proceseve transparente dhe profesionale, duke synuar qasje të plotë dhe qartë të tyre me politikën e institucionit.

Strategjia shoqërohet nga Shtojca e Planit të Veprimit, që përshkruan njësitë përgjegjëse për realizimin e tyre, kohën e realizimit dhe kostot financiare.

Objektivat e formuluar në këtë strategji janë:

- Përmirësimi i proceseve dhe praktikave për përzgjedhjen, rekrutimin dhe punësimin;
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të performancës;
- Transformimi konceptual dhe forcimi i strukturave të menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore
- Përmirësimi i shërbimeve;
- Përmirësimi i politikave dhe programeve për diversitetin e burimeve njerëzore, veçanërisht përfshirja/angazhimi i grave në inteligjencë;
- Ndërtimi dhe zhvillimi i një stafi dhe sistemi

Qasja e re e burimeve njerëzore ka shtatë komponentë:

1. Misioni, Vizioni dhe Vlerat, të cilat shprehin qasjen në këto koncepte ndaj burimeve njerëzore si kapital thelbësor dhe i rëndësishëm i institucionit;
2. Qëllimi nëpërmjet të cilit shprehet arsyetimi dhe nevoja për të hartuar një strategji të burimeve njerëzore;
3. Situata aktuale e burimeve njerëzore/sfidat, pjesë e rëndësishme e strategjisë, mbi të cilën janë ndërtuar edhe objektivat, të ngritura mbi një analizë dhe vlerësim metodik të gjendjes aktuale të burimeve njerëzore dhe përcaktimit të sfidave të së ardhmes;
4. Ciklin jetësor të punonjësit të SHISH-it, që shpreh të gjithë ecurinë e profilin jetësor të punonjësit në Shërbim;
5. Sfondin e strukturave për menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, që është një prezantim i shkurtër i misionit dhe përgjegjësi të këtyre strukturave;
6. Objektivat e përcaktuara në bazë të analizës SWOT të gjendjes aktuale dhe që shprehin në mënyrë të qartë dhe të plotë synimet e perspektivës së institucionit në lidhje me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore;
7. Zbatimin e Strategjisë që siguron një udhëzues të përgjithshëm organizativ, me qëllim për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të kësaj strategjie.

m e n a x h i m i profesional;

- Krijimi dhe zhvillimi i kulturës së lidershit.

Në procesin e implementimit të kësaj strategjie janë të angazhuara strukturat përgjegjëse për menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, përfshi njësitë teknike-administrative, të cilat brenda kompetencave dhe autoritetit të tyre, kanë përgjegjësitë menaxhimin dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore.

Strategjia shoqërohet me Planin e Veprimit, i cili ka për qëllim të mbështesë përmbushjen dhe realizimin e objektivave strategjike që lidhen me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe strukturave të angazhuara me proceset e burimeve njerëzore, në-

përmjet përcaktimit të objektivave specifike, veprimeve që do të kryhen, angazhimit të njësisë përgjegjëse, njësisë bashkëpunuese, brenda kohës dhe kostove financiare, të parashikuara për periudhën afatmesme të zbatimit të Strategjisë së Burimeve Njerëzore 2020-2023.

Plani i Veprimit të Strategjisë së Burimeve Njerëzore është përlogaritur të jetë brenda Kërkesave Buxhetore Afatmesme të SHISH-it, duke synuar jo vetëm maksimalizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, por edhe ato financiare. Kostot financiare janë në përputhje me tavanet e miratuara në Ligjin 58/2019 "Për buxhetin e vitit 2020" dhe kërkesat buxhetore të SHISH-it sipas dokumentit përfundimtar të PBA-së 2021-2023.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare, për hartimin e Strategjive Ndërsektoriale, gjatë periudhës tetor - dhjetor 2020, SHISH-i ka qenë pjesë e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për hartimin e dy strategjive ndërsektoriale përkatësisht, “Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Terrorizmit dhe Planit të Veprimit 2021-2025” dhe “Strategjisë Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planit të Veprimit 2021-2022”, të cilat u draftuan

nën drejtimin e Ministrisë së Brendshme.

Për të dyja strategjitë, kontributi i SHISH-it ka qenë konkret e objektiv, ku propozimet janë mbështetur në vlerësime dhe analiza të situatës aktuale dhe në zhvillim të këtyre fenomeneve, vlerësimet e vazhdueshme që institucioni ynë ka bërë mbi nivelet e kërcënimit të terrorizmit dhe krimit të organizuar, që cenojnë sigurinë kombëtare. Kontributi i SHISH-it është vlerësuar nga institucioni përgjegjës për koordinimin dhe draftimin e këtyre dokumenteve.

PROCESI I KONTROLLIT DHE VERIFIKIMIT TË FIGURËS



SHISH-i, si një nga institucionet e sigurisë kombëtare, është i përfshirë në procesin e kontrollit dhe verifikimit të figurës (vetting). Ky proces vijon me volum në rritje dhe me intensitet. Gjatë vitit 2020, është kryer një punë voluminoze për kthimin e përgjigjeve për kërkesat nga institucionet e tjera dhe për plotësimin e praktikave brenda afateve të kërkuara.

Në këtë kuadër, është rritur bashkëpunimi me

Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), lidhur me procesin e rivlerësimit të subjekteve të sistemit të drejtësisë.

Shërbimi ka përgatitur mbi 3000 praktika për personat dhe rrethin e personave të verifikuar. Në aspektin numerik, dominojnë Lejet e Qëndrimit, me mbi 7000 persona të verifikuar, apo aplikimet për vizë, (rreth 3000).

Lidhur me përfshirjen e Shërbimit Informativ të Shtetit në procesin e Vetingut, mund të shfaqen keqkuptime të shkaktuara nga mosnjohja e procesit. Ja disa prej tyre:

1. Zyrtari që kryen vetingun vendos se cila figurë është e pastër dhe cila jo.

E vërteta është se zyrtari vetëm verifikon informacionet që ekzistojnë në bazën e të dhënave dhe ia paraqet materialet komisionit përkatës, i cili merr edhe vendimin përfundimtar. Informacioni i mbledhur gjatë procesit u kalohet vetëm atyre që duhet ta njohin, që do të thotë se vetëm një numër i vogël njerëzish kanë qasje në të.

2. Zyrtari që kryen vetingun gërmon në jetën private të aplikuesit edhe jashtë fushave të kërkesës.

E vërteta është se hollësitë e jetës së aplikuesit janë të rëndësishme për të kryer vetingun e figurës së tij, por ne kontrollojmë vetëm ato të dhëna që kanë të bëjnë me objektin e vetingut.

3. Personat që i nënshtrohen vetingut vendosen në përgjim nga SHISH-i.

Ligji shqiptar i përcakton qartë rastet kur vihet në përgjim komunikimi i një shtetasi. Për më tepër, vetingu kryhet sipas ligjit të vetingut dhe nuk është ky kushti kryesor për t'u vendosur në përgjim komunikimi i tij, por janë të dhënat nëse ky person kryen ose jo veprimtari kriminale.



NDRYSHIMI I STATUSIT TË PUNONJËSIT TË SHISH-IT

Me Ligjin nr.97, datë 23.7.2020, janë miratuar disa ndryshime në statusin e punonjësit të SHISH-it, që konsistojnë në përmirësimin e tij dhe krijimin e kushteve më të mira për trajtimin e punonjësve, e konkretisht:

Saktësimin e njohjes se vjetërsisë në punë, kërkesat për t'u pranuar në

SHISH, emërimin e punonjësve dhe periudhën e provës, vlerësimin e punës, kriteret për ngritje në detyrë, për transferimin e punonjësit dhe përfitimet financiare për këtë problem, rregullimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, si dhe për lirimin e punonjësve nga detyra.



LIGJI I STATUSIT TË PUNONJËSIT TË SHISH-IT

Kuadri ligjor, i cili rregullon veprimtarinë e SHISH-it dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e punonjësit të SHISH-it, përbëhet nga dy ligje kryesore:

- Ligji nr. 8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar
- Ligji nr.9357, datë 17.03.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, i ndryshuar.

Në fund të vitit 2019 dhe në vazhdim, Shërbimi Informativ i Shtetit ka ndërmarrë një nismë nën kujdesin e zyrës së Kryeministrit për ndryshimin e këtij të fundit, i cili u finalizua me miratimin e Ligjit nr. 97/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9357, datë 17.3.2005, “Për statusin e punonjësit të shërbimit informativ të shtetit”, të ndryshuar”.

Qëllimi i këtij amendamenti ishte përmirësimi i statusit të punonjësit të SHISH-it, duke promovuar cilësinë dhe efikasitetin në kryerjen e detyrës, nëpërmjet vlerësimit të aftësive profesionale dhe etike të punonjësit, të cilat të reflektohen qartë në përparimin në karrierë të punonjësit brenda strukturës së SHISH-it. Përmirësimi në mënyrë të vazhdueshme i marrëdhënies së punës në Shërbim, synon arritjen e standardeve të qëndrueshme që nga dita e aplikimit për punë në Shërbim deri në përfundimin e marrëdhënies së punës. Qëllim në vetvete, SHISH-i ka maksimalizimin e arritjeve gjatë kësaj periudhe si dhe trajtimin me dinjitet gjatë periudhës së pensionimit duke shfrytëzuar ekspertizën e ish-punonjësve dhe përgatitjen e një brezi të ri inspektorësh, i cili të ndërthurë energjinë dhe maturimin e nevojshëm në realizimin e objektivave të punës.

Nëpërmjet këtij amendimi, synohet që punonjësi i SHISH-it, në realizimin e detyrave të përcaktuara në objektin e punës, që përfshijnë informimin lidhur me krimin e organizuar e korrupsionin, terrorin, përhapjen e armëve të dëmtimit në masë, krimet kundër mjedisit, duke synuar ruajtjen e integritetit, pavarësisë dhe rendit kushtetues, të përdorë forma dhe metoda pune të parashikuara në ligj dhe që mundësojnë realizimin me sukses të detyrës, në mjedisin e

sotëm ku natyra e kërcënimeve është gjithmonë e më shumë fluide, shumë komplekse, e kamufluar dhe me avantazhe teknologjike.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij amendimi, synohet sigurimi i një mbrojtjeje të veçantë për punonjësit e SHISH-it, që përballen përditë me luftën kundër krimit, mbrojtje e cila duhet të jetë domosdoshmërisht proporcionale e t'i përgjigjet vështirësisë reale të punës së tyre.

Ky amendim nuk ka sjellë ndryshime thelbësore në statusin e punonjësit, por ka rregulluar disa aspekte të rëndësishme të marrëdhënies së punës, si vjetërsia e punës, vlerësimi i punës, periudha e kursit bazë apo ndërprerja e marrëdhënies së punës me Shërbimin, të cilat, në kompleks, do të kenë një ndikim të konsiderueshëm në rritjen e performacës së strukturave të SHISH-it.

Kështu, në mënyrë specifike, nëpërmjet këtij amendimi, u synua që të liberalizohet procesi i përparimit në karrierë në nivelet e mesme të menaxhimit, edhe me shkallë vlerësimi “mirë”, kjo për shkak dhe të dinamikave dhe proceseve të punës në Shërbimin Informativ të Shtetit. Kështu synohet të motivohen për t'u ngritur në karrierë të gjithë ata punonjës që kanë vlerësim “mirë”, që janë të angazhuar fort por, dhe për shkak të ndonjë gabimi, mund të penalizohen, dhe që kanë aftësi në drejtime të ndryshme të punës në Shërbim, krahasimisht vetëm me ata punonjës të cilët, për shkak të mosangazhimit, mund të kenë një CV të pastër dhe të panjollë.

Ky amendim ligjor synon të garantojë trajtim financiar dinjitoz dhe të përshtatshëm të punonjësve të Shërbimit, të cilët për interesa pune transferohen, kjo për shkak të natyrës së veçantë të punës. Mbulimi i shpenzimeve do të motivonte punonjësit për të punuar edhe në ato rrethe ku nuk e kanë të siguruar infrastrukturën e nevojshme për të jetuar. Gjithashtu, është përcaktuar dhe një afat lidhur me transferimin, i cili nuk mund të jetë më shumë se 3 vjet, duke përcaktuar një garanci më shumë për menaxhimin dhe shfrytëzimi me efektivitet të burimeve njerëzore, duke plotësuar nevojat me burimet ekzistuese, apo dhe duke bërë planifikimin e rekrutimeve të reja specifike.

Ky trajtim financiar i siguron punonjësit rimbursimin e plotë të shpenzimeve të transferimit të tij dhe/ose të familjes, kompensim për qira banese të akomodimit të tij dhe/ose të familjes, kur ai ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi në vendin e ri të punës ose kompensimi për udhëtim.

Ky amendim ligjor synon gjithashtu saktësimin dhe plotësimin e periudhave për efekt pensioni, duke unifikuar kohën e studimit në shkollat e larta ushtarake, të policisë dhe në shkollat me natyrë të ngjashme me to, me kohën e studimit në këto shkolla jashtë vendit. Për shkak të specifikës së punës së SHISH-it, por edhe mënyrës së pagesës së siguracioneve për punonjësit, ka vështirësi për njohjen për efekt pensioni të kohës si punonjës në disa struktura të veçanta në SHISH. Procedura e njohjes do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Një risi e këtij amendimi ligjor është edhe parashikimi i trajtimit financiar të mentorit, kjo për shkak të specifikës së veçantë të punës së Shërbimit. Roli i mentorit në SHISH është kritik për vijimësinë e veprimtarisë së Shërbimit, pasi puna në SHISH është profesion relativisht i vështirë që nuk mund të vetëmësohet apo të merret nëpërmjet shkollimit.

Më qëllim motivimin e mentorit për t'ia trashëguar profesionin punonjësit të ri, është menduar t'i jepet një shpërblim sipas përcaktimit në udhëzimin e Drejtorit të SHISH-it, përvojë kjo e marrë nga shërbimet partnere, duke rënë dakord edhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

lidhur me përcaktimin e fondit për këtë qëllim.

Në kuadër të menaxhimit me efektivitet dhe efikasitet të burimeve njerëzore, si aseti më i rëndësishëm i SHISH-it, duke investuar në kualifikimin dhe ngritjen profesionale të punonjësve nëpërmjet trajnimeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, është synuar rregullimi i realizimit të kthimit të investimit brenda strukturës së SHISH-it. Kështu, është parashikuar që, në rastet e trajnimit afatgjatë nga Shërbimi për një periudhë mbi gjashtë muaj, brenda dhe jashtë vendit, punonjësi është i detyruar të qëndrojë në SHISH dy vjet pas kryerjes së tij, në të kundërt kthen pagën dhe shpenzimet e trajnimit. Mënyra e përlogaritjes së shpenzimeve përcaktohet me urdhër të Drejtorit të SHISH-it.

Kushti i sigurisë është një nga kriteret kryesore që duhet të plotësojnë personat që punësohen në Shërbimin Informativ të Shtetit, krahas kërkesave të përgjithshme. Verifikimi i kushtit të sigurisë zbatohet ndaj personit, i cili kërkon të punësohet në SHISH, si dhe për lidhjet e tij me personat e familjes ose jashtë saj, si dhe ndaj punonjësve në detyrë. Personat që nuk plotësojnë kushtin e sigurisë, nuk mund të lidhin marrëdhënie pune me SHISH-in, apo të vazhdojnë këtë marrëdhënie pune me Shërbimin. Ky amendim ligjor qartësoi dhe njëherë kushtet e lirimit vetëm për shkak të mospërmbylljes së kushtit të sigurisë, e cila më herët ishte e përcaktuar vetëm në nenin 5 të statusit, sipas të cilit, kush nuk plotëson kushtin e sigurisë, nuk mund të qëndrojë në punë në Shërbim, por pa u specifikuar si një nga rastet e lirimit sipas nenit 45.



REKRUTIMET 2020

Për vitin 2020, vijuan procedurat e rekrutimeve bazuar në urdhrin e brendshëm përkatës mbi testimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve që pranohen si inspektorë në SHISH, i ndryshuar për shkak të pandemisë Covid 19.

Ky urdhër u përgatit pas një studimi paraprak të vendeve të lira që ishin në momentin e vlerësimit, në numrin mesatar të punonjësve që, për arsye familjare, shëndetësore e të ndryshme, mund të kërkojnë lirim, në numrin e punonjësve që mbushin kriteret për pension pleqërie si dhe nevojat që ka SHISH-i për burime njerëzore me gjuhë të rrallë.

Rekrutimi i inspektoreve të terrenit, për vitin 2020, ka vijuar procedurat duke kaluar të gjitha fazat që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore, duke i renditur, si më poshtë:

- Ngritjen e Komisionit të Pranimi (KP), për kryerjen e të gjitha procedurave të nevojshme, për përzgjedhjen e kandidatëve (aplikantëve) që do të punësohen në SHISH.

- Përcaktimin e procedurës dhe punës, hartimin e kriterëve, kërkesave dhe afateve që duhet të plotësojnë kandidatët (aplikantët) që do të konkurrojnë për inspektorë në SHISH.

- Shpalljen e nevojave për punonjës në media si dhe në faqen zyrtare të internetit të SHISH-it, mbledhjen e dokumentacionit të kandidatëve (aplikantëve) në njësinë e burimeve njerëzore,

përgatitjen e statistikave të plota dhe të detajuara për të dhënat e të gjithë kandidatëve.

Ka pasur një zgjatje periudhe rekrutimi nga afati i parashikuar, kjo referuar akteve ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë periudhën COVID 19.

Kandidatët që plotësonin kriteret, iu nënshtuan testimit me shkrim dhe me gojë sipas kriterëve të përcaktuara në urdhrin e Drejtorit të SHISH-it.

Rezulton se kanë aplikuar gjithsej 277 veta.

Në testimin me shkrim u miratuan për të marrë pjesë gjithsej 244 aplikantë që plotësonin kriteret e parashikuara në urdhrin e Drejtorit të SHISH-it.


Morën pjesë në testimin me shkrim gjithsej 231 aplikantë.


Në testimin me gojë morën pjesë 111 kandidatë.

Vlerësimi përfundimtar u bazua në pikët e marra në dy fazat e testimit, pra u mor si vlerësim përfundimtar shuma e pikëve të testimit me shkrim dhe testimit me gojë, për secilin aplikant.

KP i propozoi Drejtorit të SHISH-it që të shpallen 45 kandidatura fituese dhe 40 kandidatura në listë pritjeje. Me miratimin e Drejtorit të SHISH-it, struktura përgjegjëse për sigurinë e burimeve njerëzore verifikoi kushtin e sigurisë për 45 kandidaturat fituese dhe 40 kandidaturat në listë pritjeje, sipas renditjes nga Komisioni i Pranimi.

Në përfundim të procesit, aktualisht vazhdojnë kursin bazë 9-mujor për inspektorë 44 kandidatë.





PO MËSOJ...

Quem Denisa, jam kursante në SHISH. Pas kalimit me sukses të disa fazave të procesit të konkurrimit, u bëra pjesë e Shërbimit Informativ të Shtetit. Më herët kam pasur përvoja pune në administratën publike, në organet ligjzbatuese, në organizata ndërkombëtare, si dhe në sektorin privat. Gjatë përvojës së punës në administratën publike por edhe në vende të tjera, kam pasur mundësinë të menaxhoja dhe të zbatoja projekte të ndryshme, kryesisht në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Menjëherë pas fillimit të punës në SHISH, iu nënshtrova një trajnimi bazë profesional pranë Qendrës së Trajnimit në SHISH. Mendoja se e njihja mirë mënyrën se si funksionon administrata dhe kjo do të më lehtësonte procesin e përshtatjes me pozicionin e ri të punës në SHISH. Por, gjatë kësaj periudhe, kam vërejtur disa elementë që e bëjnë të veçantë dhe interesant këtë trajnim.

Pjesëmarrja në trajnim e punonjësve nga organizata të ndryshme të sigurisë, struktura të ndryshme, fusha të ndryshme dhe me përvoja të ndryshme jetësore, e bën zhvillimin e lëndëve edhe më interesante. Aty ku një pjesë e pjesëmarrësve nuk kanë informacion është dikush që e ka kaluar më parë situatën dhe ofron eksperiencën e tij. Shkëmbimi i përvojave është shumë i rëndësishëm për ne. Të gjithë japin perspektivën e tyre duke të mundësuar të mendosh ndryshe, të mendosh “jashtë kornizës”. Është vështirë të gjesh në ambientin e punës kaq shumë diversitet. Gjatë trajnimit, në pushimet midis orëve, të jepet mundësia të përfitosh nga eksperiencia e

Denisa - studente

gjithsecilit.

Çdo ditë, në Qendrën e Trajnimit të SHISH, është sfiduese, pasi duhet të fitosh besimin e instruktorëve dhe të kursantëve të tjerë dhe të mësosh shpejt nga gabimet. Stafi mësimdhënës, që zhvillon dhe drejton kursin, kanë një kombinim perfekt të zotërimit të informacionit teorik dhe të përvojave vetjake. Çdo koncept e informacion ilustrohet me shembuj jetësorë. Leksionet e detajuara japin pamje të qartë të situatave, koncepteve dhe përkufizimeve. Të gjitha realizohen duke pasur në mendje gjithmonë, qëllimin kryesor të punës sonë, mbrojtjen e sigurisë kombëtare. Stafi pedagogjik, me një profesionalizëm të spikatur, përpiqet të përmirësojë aftësitë e nevojshme të çdo kursant. Ajo që është mbresëlënëse, është kultivimi i ndjenjës së patriotizmit, si vlerë unike dhe e domosdoshme që duhet ta ketë secili prej nesh. Gjatë kursit po kuptoj se, vizioni i SHISH-it, i shprehur në fjalët e rilindësit Sami Frashëri: “Të përpiqemi për të drejtët tënë... për të mirët të kombit tënë...”, nuk është thjesht një parullë propagandistike që mbetet në letër. Në këtë kurs rritemi jo vetëm profesionalisht, por edukohemi edhe me vetitë më të larta humane dhe rritim vetëdijen kombëtare.

Trajnimi ka elemente të rëndësishëm të formimit të përgjithshëm dhe profesional. Koncepte, përkufizime dhe informacione që i dija ose i kisha dëgjuar diku, sqarohen me profesionalizëm dhe gjejnë vend në puzzle-in e dijes. Informacioni strukturohet duke të dhënë pamje më të qartë të së tërës.

Paraprakisht, kisha paragjykimin se do të ishte një nga ato trajnimet që kryhen rëndom, sa për të kaluar radhën, por jo, nuk është ashtu.

Po Mësoj! Pavarësisht përvojës dhe moshës, unë po mësoj. Fjalët e Dritëro Agollit drejtuar një grupi studentësh tingëllojnë kaq të vërteta dhe aktuale: “Njeriu mëson gjithë jetën.

Që kur është i vogël fare deri kur bëhet plak. Njeriu mëson të ngrihet në këmbë, të hajë, mëson të bëhet i ri, të dashurojë, mëson të bëhet plak... Kështu që, njeriu tërë jetën mëson dhe, në përgjithësi, njeriu është student gjithmonë”.



TRAJNIMET

Pavarësisht vështirësive që solli pandemia e COVID-19, Qendra e Trajnimit të SHISH-it, ka vijuar aktivitetin duke realizuar 25 trajnime specializimi në të cilat janë trajnuar 336 punonjës të SHISH, 44 punonjës të SHÇBA-së, 10 punonjës të AISM-së. Disa nga këto trajnime janë realizuar në bashkëpunim edhe me institucione të tjera, si Akademia e Sigurisë, AISM-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP). Gjithashtu, janë realizuar 4 trajnime të formimit bazë profesional, ku janë trajnuar në total 99 punonjës nga të cilët 88 punonjës të SHISH-it dhe 11 punonjës të AISM-së.

Njëkohësisht, ka vijuar bashkëpunimi në organizimin e trajnimeve me partnerët tanë, ku veçojmë gjatë vitit 2020, zhvillimin e një sesi online lidhur me ecurinë dhe treguesit e programit të trajnimit të organizuar në bashkëpunim me OSBE/UNODC dhe ICITAP, gjatë viteve 2018-2020, në të cilin ekspertë të SHISH-it kanë marr pjesë si trajnues kombëtarë.

Ky program trajnimi është përqendruar në

luftën kundër financimit të terrorizmit dhe në të kanë marr pjesë 4 punonjës të SHISH-it. Programi organizohet nga Departamenti i Sekretariatit të OSBE-së për Kërcënimet Transnacionale, në bashkëpunim me Programin Global të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) Programi Global kundër Pastrimit të Parave (GPML), Prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe me mbështetjen e Programit Ndërkombëtar të Ndihmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal (ICITAP), të Departamenti të Drejtësisë (DOJ) të Shteteve të Bashkuara.

Referuar edhe vlerësimeve të raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) për Terrorizmin, publikuar gjatë vitit 2020, ky kurs trajnimi ishte pjesë e një programi shumëvjeçar të OSBE/UNODC, për ndërtimin e kapaciteteve për të mbështetur përpjekjet kombëtare për të luftuar financimin e terrorizmit në Evropën Juglindore, në përputhje me Rezolutën nr. 2462 (2019), të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, standardet FATF dhe angazhimet e OSBE-së.

QENDRA E TRAJNIMIT

SHISH-i i kushton vëmendje të veçantë trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të punonjësve të tij. Ekuilibri, profesionalizmi dhe udhëzimet e lidershit orientojnë veprimin tonë.

Ligji nr. 9357, datë 17.03.2005 “Për Statusin e Punonjësit të SHISH-it”, përcakton në nenin 13/e se, ndër detyrat kryesore të punonjësit të SHISH-it është rritja e aftësive profesionale të tij dhe marrja pjesë në veprimtari trajnuese. Gjithashtu, neni 30/c përcakton se, punonjësi i

SHISH-it ka të drejtë të trajnohet, të kualifikohet dhe të ndjekë studimet, brenda e jashtë vendit, me leje të Drejtorit.

SHISH-i ka qendrën e tij të trajnimeve. Qendra e Trajnimit të SHISH-it është krijuar me VKM Nr. 410, datë 15.09.1992, “Për krijimin e Institutit të Shërbimit Informativ Kombëtar”.

Veprimtaria e saj normohet nga VKM Nr. 1400, datë 17.10.2008, “Për organizimin e kurseve në SHISH dhe trajnimin e pjesëmarrësve”, i ndryshuar me VKM Nr. 474, datë 25.07.2012, e cila përcakton se: “Në Institutin



e Shërbimit Informativ të Shtetit (Instituti i SHISH-it) të organizohen kurse, për përgatitjen informative e formimin bazë profesional, si dhe kurse kualifikimi dhe specializimi të punonjësve të SHISH-it, në funksion të sigurisë kombëtare. Lloji dhe kohëzgjatja e kurseve përcaktohen me urdhër të drejtorit të SHISH-it’.

Misioni i Qendrës së Trajnimit përfshin:

- Përgatitjen profesionale dhe formimin bazë të punonjësve të rinj të SHISH-it.
- Kualifikimin profesional dhe specializimin e vazhdueshëm të punonjësve në detyrë të SHISH-it.
- Përhapjen e përvojave dhe teknikave të reja profesionale, me qëllim rritjen e efikasitetit përkundrejt kërcënimeve “të reja”, veça-

nërisht ato që rëndojnë mbi sistemin ekonomiko-financiar, hapësirën kibernetike dhe infrastrukturën e tjera kritike. Për këtë qëllim, bashkëpunohet edhe me organizatat homologe jashtë vendit.

Qendra e Trajnimit të SHISH-it i shërben të gjithë komunitetit të inteligjencës dhe sigurisë në vendin tonë, duke u ofruar trajnime në fushën e inteligjencës edhe punonjësve nga:

- AISM (Ministria e Mbrojtjes)
- SHÇBA (Ministria e Brendshme)
- SHKBB (Ministria e Drejtësisë)

Qendra e Trajnimit, me qëllim përhapjen dhe promovimin e kulturës së sigurisë, bashkëpunon edhe me institucionet e tjera të administratës publike dhe të arsimit në vend.

STRUKTURA E RE E SHISH-IT

Për vitin 2020, në funksion të objektivave të miratuara për mbledhjen, grumbullimin, përpunimin e informacionit, si dhe rritjen e efikasitetit të punës operative, u miratua ndryshimi i strukturës së re të SHISH-it.

Ky ndryshim konsiston organizimin e Drejtorive të Bazës në Drejtori Rajonale. Në këtë strukturë u miratuan disa Drejtori Rajonale referuar projektit pilot të Drejtorisë Rajonale Fier, parashikuar në strukturën e mëparshme. Nga implementimi i kësaj strukture, është rritur numri i funksioneve operative dhe janë shkurtuar funksionet mbështetëse që dilnin të tepërta. Të gjithë punonjësit të cilëve u ishin shkurtuar pozicionet e punës, u sistemuan në vende të tjera brenda organikës. Pas implementimit të strukturës së re, vërejmë funksionim efikas në të gjitha nivelet dhe ecuri me rritje progresive të procesit të kërkimit, verifikimit, dokumentimit dhe vlerësimit të informacionit.

Nëpërmjet këtij organizimi strukturor, janë konsoliduar dhe forcuar kompetencat e njësive në bazë, duke u dhënë mundësi ndërveprimi në funksion të realizimit të detyrave, për organizimin, planifikimin dhe kontrollin e procesit informativ.

Më konkretisht:

- shpejtësi në qarkullimin e informacionit;
- koordinim për situatat në ndjekje me objekt të përbashkët mes njësive në rrethe të ndryshme;
- rritje të cilësisë së informacionit dhe ndjekjen nga afër të situatave operative,
- rritje të prezencës të inspektorëve të kërkimit në terren;
- ulje e numrit të hallkave drejtuese dhe të sektorit ndihmës;
- konsolidim dhe forcim i kompetencave të njësive në bazë, duke krijuar mundësi ndërveprimi në funksion të realizimit të detyrave, për organizimin, planifikimin dhe kontrollin e procesit informativ;
- njohje më të mirë të situatës operative në nivel rajonal;
- mundësi kontrolli më i përqendruar për situata të veçanta;
- organizim më të mirë të punës në grup dhe ndarjes së detyrave, sipas aftësive profesionale dhe aksesit në sigurimin e informacionit;
- organizim më të gjithanshëm i punës së degës në funksion të nevojave reale operative sipas dinamikës së drejtorive.

GRATË NË KOMUNITETIN E INTELIGJENCËS

Në realizimin me sukses të detyrave që i ngarkohen një pjesëtarit të komunitetit të inteligjencës, është shumë i rëndësishëm roli i familjes. Vështirësia dhe specifika e veprimtarive në mbrojtje të sigurisë kombëtare është e tillë, që kërkon durim, mirëkuptim e ndihmë nga njerëzit e afërt. Prej vitesh, situata në çështjet e inteligjencës e të sigurisë kombëtare, për sa i përket ndarjes së roleve, ka ndryshuar, duke mos qenë më punë ekskluzivisht për burra. Gradualisht, koleget tona, jo vetëm janë shtuar në numër brenda radhëve të Shërbimit Informativ të Shtetit, por kanë marrë gjithnjë e më tepër përgjegjësi ndër më të spikaturat.

Prej më shumë se 3 vjetësh, qasja e ekipit drejtues të SHISH-it ka qenë e fokusuar, jo thjesht drejt barazisë gjinore apo diskriminimit pozitiv për gratë, por në krijimin e shanseve të barabarta për punësim e karrierë. Mbështetja dhe promovimi i grave në pozicione drejtuese është vënë re se e ka përmirësuar më tej mjedisin pozitiv të punës që mbizotëron në institucionin tonë.

Përveç barazisë në paga dhe dhënies së mundësive të promovimit në karrierë, gratë në pozicione drejtuese kanë demonstruar sens të lartë përgjegjshmërie, përkushtim në realizimin e detyrave, kryerjen e disa detyrave njëkohësisht, rezultate në menaxhimin e grupeve të punës

dhe njërive të ndryshme, si dhe kanë dhënë zgjidhje profesionale për shumë nga problemet në ndjekje, duke sjellë perspektiva, aftësi dhe këndvështrime të ndryshme për zgjidhjen e problemeve. Me një sens tjetër ndjeshmërie dhe me qasje më të ndryshme nga burrat, gratë mund të dallojnë dhe identifikojë hollësi më të imta dhe më të ndryshme nga meshkujt, që vlejné për situata të ndryshme operative dhe të sugjerojnë zgjidhje inovative dhe efektive.

SHISH-i ka bërë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, duke promovuar dhe emëruar në pozicione të rëndësishme drejtuese zonja. Aktualisht, 25% e numrit total të punonjësve të SHISH janë gra ndërsa, për herë të parë, kemi 30 zonja në pozicione drejtuese, numër ky dy herë më i lartë krahasuar me pak vite më parë.

Megjithatë, mbetet ende shumë për t'u bërë, që kjo frymë të përhapet edhe në njësitë tona rajonale, me qëllim dhënien e mundësive dhe kombinimin e roleve drejtuese në të gjithë Shërbimin. Ne jemi të vetëdijshëm për vështirësitë e punës në terren, në qytete e zona të vogla, ku presioni negativ, paragjykimimi dhe elementë të tjerë të trashëguar të shoqërisë, mund të jenë frenues për shumë gra e

vajza për t'iu bashkuar Shërbimit Informativ. Por vizioni i drejtuesve është që ky proces të vijojë pa ngurrim e pa paragjykime, mbështetur në strategji e plane veprimi, për ta pasuruar Shërbimin me gra e vajza të përkushtuara për t'u bërë pjesë e misionit tonë.



AKTIVITETI FINANCIAR I SHISH-IT

Shërbimi Informativ i Shtetit, gjatë vitit 2020, ka administruar një buxhet në shumën (1,685,905 mijë lekë) 1,69 miliard lekë nga 1,63 miliard (1,629,809 mijë lekë) vitin e kaluar. Për periudhën 2017 deri më 2020, trendi buxhetor është në rritje, duke përballuar në këtë mënyrë, kërkesat në rritje për fonde, si përgjigje ndaj veprimtarive më të sofistikuara që cenojnë sigurinë kombëtare.


Realizimi i buxhetit të SHISH për periudhën 2013-2020, paraqitet si më poshtë.

Në çdo vit, pjesën më të madhe të buxhetit të SHISH-it e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime për personelin, si një faktor i rëndësishëm për motivimin dhe përthithjen e kategorive më efektive të burimeve njerëzore. Në vijim të aplikimit të politikave për nxitjen e burimeve njerëzore, në vitin 2019, me VKM

nr.259, datë 24.04.2019, pagat në SHISH patën një rritje rreth 17.7%.

Gjatë vitit 2020, fondet për mallra dhe shërbime janë menaxhuar më së miri në plotësimin e nevojave për shpenzime të sektorit operativ, por edhe të gjitha materialeve dhe shërbimeve të domosdoshme për punën e punonjësve. Gjithashtu, janë mirëmbajtur sisteme të rëndësishme që kontribuojnë drejtpërsëdrejti në realizimin e produktit informativ.

Investimet për vitin 2020, realizuar në shumën 43,651,000 ndaj programimit, u fokusuan në blerje pajisjesh të teknologjisë së informacionit, me qëllim modernizimin e tyre, blerje automjetesh si dhe rikonstruksione e ndërtime të objekteve në administrim të SHISH-it, me qëllim krijimin e kushteve optimale të punës së punonjësve.



Buxheti i SHISH-it ndër vite (në milion L.ekë)

Në vitin 2020, u evidentuan objektet e dëmtuara nga tërmeti dhe u kryen të gjitha procedurat e nevojshme deri në sigurimin e fondeve për rehabilitimin e tyre, e finalizuar me VKM nr.48, datë 27.01.2021, “Për përdorimin e Fondit Rindërtimit, për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit/riforcimit të objekteve në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit, në bashkitë Durrës dhe Lezhë”.

FJALORI TERMINOLOGJIK I SIGURISË DHE INTELIGJENCËS

Në përgjigje të nevojave të kohës dhe atyre të perspektivës, SHISH-i ka hartuar Fjalorin e Parë Terminologjik të Sigurisë dhe Inteligjencës, në shqip dhe anglisht, i cili përmbledh fjalë dhe terma që përdoren nga institucioni në punën e përditshme, në administrimin e dokumentacionit, në komunikimet brenda si Shërbimit ashtu edhe në bashkëpunim me shërbimet sekrete partnere.

Fjalori është përpiluar nga një grup pune i përbërë nga punonjësit e SHISH-it, duke u mbështetur

në përvojën e fituar ndër vite, në praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe inteligjencës, në terminologjinë e shërbimeve sekrete partnere, në fjalorë të tjerë të fushës, të disponueshëm nga burimet e hapura, si dhe në fjalorët e mëparshëm të hartuar ndër vite në SHISH.

Fjalori përmbush një boshllëk të krijuar ndër vite dhe është hartuar në variantin shqip-anglisht. Për disa nga fjalët dhe termat, është dhënë shpjegimi fillestar dhe më i përgjithshëm njohës dhe më pas është konkretizuar me më shumë hollësi, në kuptimin e gjuhës së sigurisë dhe inteligjencës, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fushën e veprimtarisë së SHISH-it


Fjalori paraqet një përpjekje serioze për të përmbledhur në një vëllim të vetëm termat

dhe konceptet e fushave operative, informative dhe të sigurisë, për të konsoliduar gjuhën në komunikimin verbal dhe shkresor, duke përfshirë fjalë, grupe fjalësh dhe shembuj, që gjejnë përdorim të përditshëm në aspektet teorike, analitike, praktike, operacionale, teknike, strategjike, të informacionit të klasifikuar si dhe sigurisë kombëtare në përgjithësi.

Fjalori do të shërbejë për ngritjen profesionale të punonjësve në detyrë dhe do të jetë një udhërrëfyes i dobishëm për punonjësit e rinj, për të mësuar termat e “gjuhës së zanatit” që përdoret në komunitetin e inteligjencës dhe të sigurisë në vendin tonë dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Fjalori është i aksesueshëm për të gjithë punonjësit e institucionit dhe vlerësojmë se do të do t’u ndihmojë në mbarëvajtjen e punëve në Shërbim, do të kontribuojë që punonjësit të familjarizohen me terminologjinë kombëtare dhe ndërkombëtare të inteligjencës dhe sigurisë, në ngritjen e profesionalizmit dhe përputhshmërisë me praktikat më të mira të shërbimeve partnere.

Fjalori do të përdoret fillimisht brenda strukturave të institucionit dhe, më pas, duke hequr elementë që lidhen me format dhe metodat e punës së SHISH-it, do të merret në konsideratë mundësia për t’ua ofruar edhe strukturave të tjera të sigurisë dhe inteligjencës në Republikën e Shqipërisë dhe partnerëve tanë strategjikë.



DISA FJALË E TERMA NGA "GJUHA E ZANATIT" QË MUND TË VIJNË NË NDIHMË GJATË PROCESIT TË PUNËS

AGJENT I DYFISHTË

1. Agjent i dyfishtë është një person që rekrutohet nga dy shërbime; fillimisht nga njëri e më pas nga tjetri. Operacione të tilla janë ndër më të vështirat për t'u menaxhuar. Çështja e besnikërisë duhet të dalë në plan të parë kur vlerëson situatën. 2. Agjent në kontakt me dy shërbime sekrete kundërshtarë, ku vetëm njëri është në dijeni të kontakteve të agjentit. 3. Një person që pretendon se po spiunon një organizatë target për llogari të një organizate tjetër, por që në fakt është besnik i organizatës target.

CERTIFIKATË E SIGURIMIT TË PERSONELIT

CSP është një dokument zyrtar i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ose i një autoriteti kompetent të sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

JOMIQËSOR

1. Që tregon mospëlqim dhe mungesë simpatie. *P.sh. Ajo gjithmonë sillet në mënyrë jo-miqësore me mua.* 2. Në kuptimin e zbulimit dhe kundërzbulimit: Termi jo-miqësor u referohet shërbimeve dhe agjencive të huaja me të cilët nuk ke marrëdhënie pune, të cilët punojnë dhe kryejnë operacione informative të fshehta kundër interesave kombëtare të vendit. *P.sh. Agjencitë dhe shërbimet informative jo-mike janë objekt i punës së Shërbimi tonë.*

KRIM KIBERNETIK

Ndërhyrje e paautorizuar drejt dhe/ose përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, veprim i cili ndëshkohet sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

DOUBLE AGENT

1. Double agent is a person recruited by both sides; first by one side, then the other. Most difficult operation to run. The question of loyalty will emerge as a primary factor when assessing the case 2. Agent in contact with two opposing intelligence services, only one of which is aware of the double agent contact. 3. A person who pretends to spy on a target organization on behalf of an organization, but in fact is loyal to that target organization.

SECURITY CLEARANCE

It is a certificate issued by the competent national authority to show that relevant background checks have been conducted on the individual and he is granted access to classified information, to the level designated in the document.

NON-FRIENDLY

1. Showing dislike and no sympathy. *Ex: She always behaves in an unfriendly manner to me.* 2. In intelligence and counterintelligence use: The term non-friendly refers to hostile foreign partner services and agencies with which you do not have work relationships, who are conducting clandestine intelligence operations against the national interest of the country. *Ex: Foreign, non-friendly intelligence agencies and services are the target of our Service.*

CYBER CRIME

Unauthorized act of intrusion to and through/or use of information and communication technology, an act that is punishable, as prescribed in the Criminal Code of the Republic of Albania.

LIGJI I MËRFIT

Nëse ka mundësi që diçka të shkojë keq, atëherë do të shkojë keq. E. A. Mërfi (1949).

Termi përdoret shpesh në fushën e inteligjencës. Gjatë procesit të planifikimit të operacioneve, inspektori duhet të planifikojë gjithçka me kujdes, për të shmangur të papriturat e pakëndshme. Siç thuhet në zënat tonë, punët mund të shkojnë keq sepse Mërfi është gjithmonë aty.

MODUS OPERANDI (MO)

Shprehje latinisht, që përkthehet “Mënyra e veprimit”. Termi përdoret për të përshkruar një model apo metodë të dallueshme veprimi dhe funksionimi, të konsideruar si karakteristike apo të zakonshme, që ndjek një individ apo një organizatë e përfshirë në veprimtari kriminale apo informative. Si në shqip, ashtu edhe në anglisht, shkurtesa është MO.

PRODUKT INFORMATIV

1. Ajo që përfitohet nga grumbullimi, integrimi, analizimi, vlerësimi dhe interpretimi i të dhënave informative të disponueshme. 2. Informacion në kohë, i saktë dhe i përdorshëm, veçanërisht për veprimet e kundërshtarëve të mundshëm apo të vendeve jo-mike, i cili ndihmon politikëbërësit dhe vendimmarrësit të kryejnë misionin e tyre të formulimit dhe implementimit të politikës së sigurisë kombëtare.

SIGURI KOMBËTARE

Siguria kombëtare është identifikimi i të gjitha rreziqeve dhe kërcënimeve që mund t'i vijnë një vendi, në mënyrë të veçantë ato që kanë të bëjnë me ushtrimin e sovranitetit, mbrojtjen e pavarësisë dhe integritetin territorial, të jetës dhe pasurisë së popullatës, të vlerave kombëtare, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, qëndrueshmërisë së institucioneve shtetërore, mirëqenies së popullsisë, përfshirë mbrojtjen e vendit dhe marrëdhëniet me jashtë. *P.sh. Shërbimi Informativ i Shtetit është një agjenci, detyra e së cilës është mbrojtja e sigurisë kombëtare.*

MURPHY'S LAW

If there is a possibility for something to go wrong, it will go wrong. E.A. Murphy, Jr. (1949).

This is term used a lot in the intelligence business. During the operational planning process, the Case-Officer must plan everything carefully to avoid unexpected, unpleasant surprises. As the saying goes in our business, things may go wrong, because Murphy is always there.

MODUS OPERANDI (MO)

A Latin phrase, translated as “Method of Operating”. The term is used to describe a distinct pattern or method of operating and functioning seen as characteristic or habitually followed by an individual or an organization involved in criminal or intelligence activity. In both English and Albanian, it is frequently shortened to MO.

INTELLIGENCE (AS A) PRODUCT

1. That which results from the collection, processing, integration, analysis, evaluation, and interpretation of available information. 2. Timely, accurate, and actionable (value-added) information about what other nations or groups, especially potential adversaries, are doing which helps policymakers, decision makers, and military leaders carry out their mission of formulating and implementing national security policy.

NATIONAL SECURITY

National security is the identification of all risks and threats that may come to a country, especially those that have to do with the exercise sovereignty, protection of the independence and territorial integrity, life and property of the population, national values, constant economic development, sustainability of state institutions, well-being of the population, to include national defense and foreign relations. *For example: The State Intelligence Service of Albania is an agency whose duty is the protection of national security.*

LISTA E SHKURTESAVE

ADM - Armë të Dëmtimit në Masë
 AISM - Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
 AKSHI - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
 BE - Bashkimi Evropian
 BP - Ballkani Perëndimor
 DASH - Departamenti Amerikan i Shtetit
 DPPPP - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
 DPPSH - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
 DPV - Drejtorië e Policisë Vendore
 DOJ - Departamenti i Drejtësisë në SHBA
 FATF - Task Forca për Veprim Financiar
 GPML - Programi Globak kundër Pastrimit të Parave
 ICITAP - International Criminal Investigative Training Assistance Program
 ISIL/DAESH - Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë
 IT&T - Teknologji e Informacionit dhe Telekomunikimit
 KP - Komisioni i Pranimi
 KPK - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
 LHT - Luftëtar i Huaj Terrorist
 MEK - Organizata e Muxhahedinëve të Popullit të Iranit
 NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
 OE - Operator Ekonomik
 OFL - Operacioni Forca e Ligjit
 ONM - Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
 OSBE - Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
 PBA - Programi Buxhetor Afatmesëm
 RVM - Republika e Maqedonisë së Veriut
 SPAK - Struktura e Posaçme Anti Korrupsion
 SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës
 SHÇBA - Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
 SHISH - Shërbimi Informativ i Shtetit
 SHIVH - Shërbim Informativ i Vendeve të Huaja
 SHKBB - Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve
 TIK - Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit
 UNODC - Zyra për Drogën dhe Krimin e Kombeve të Bashkuara
 VKM - Vendim i Këshillit të Ministrave

Ky dokument është pronësi e SHISH-it. Botohet me qëllim informimin e publikut të përgjithshëm mbi veprimtarinë e SHISH-it, mbi sfidat dhe kërcënimet me të cilat përballlet vendi. Dokumenti është publik, gjendet edhe në format elektronik në adresën tonë www.shish.gov.al. Teksti dhe figurat mund të përdoren për arsye studimore e informuese, duke cituar detyrimsht burimin.

Kontakt:

Tel: +355 69 4138387

Email: transparenca@shish.gov.al

Adresa postare: Rruga “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, Shqipëri

www.shish.gov.al

TIRANË - 2021